



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
në “Turizëm Religjioz”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Logos”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



1. Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja
2. Prof. Asoc. Nevila Çinaj

Maj/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Logos”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Logos”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR nr.374, datë 23.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2021-2022: 7 PAE/ 13 PAK V.a. 2022-2023: 7 PAE/ 16 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2021-2022: 9 studentë V.a 2022-2023: 5 studentë
19	Komente / të tjera:	-

 2


PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”, organizohet nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor në Kolegjin Universitar “Logos” (KUL).

Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore duke synuar në vazhdimësi t’i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojës për turizmin religjioz, në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të KUL, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si edhe duke ndjekur veçantitë dhe risitë në fushën e turizmit fetar në vend e më gjerë.

Programi MSc në “Turizëm Religjioz” është i organizuar sipas sistemit me kohë të plotë, në dy vite akademike, i ndarë në 4 semestra dhe realizohet me 120 ECTS, në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës, miratuar nga Senati akademik i KUL. Studentët që përfundojnë me sukses këtë cikël studimesh të nivelit të dytë pajisen me diplomë Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”. Programi përmban 16 lëndë dhe tezën e diplomës në përfundim të studimeve dhe ofrohet në gjuhën shqipe.

Me strukturën e përmbajtjen e tij ky program ka si objektiv edukimin e formimin e studentëve me njohuri të thelluara në fushën e turizmit religjioz dhe të çështjeve bashkëkohore të lidhura me to. Programi ka si qëllim të formojë ekspertë, të aftë për të punuar në organizma shtetërorë, kulturorë, fetare, turistike, pranë institucioneve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me qasje ndaj problematikave të turizmit fetar për nevojat e vendit dhe më gjerë. Programi ka si qëllim promovimin e vlerave turistike, kulturore dhe fetare, për të formuar profesionistë të fushës.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”, të ofruar nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës pranë Kolegjit Universitar “Logos”, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.


ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Genti Kruja dhe Dr. Nevila Çinaj.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinator Teknik të ASCAL-it, Znj. Aleksandra Xhamo.

Vizita 2 ditore në Kolegjin Universitar “Logos” u realizua gjatë datave 11-12 Tetor 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Kolegjit Universitar “Logos” (Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës). Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.


Në fund të raportit, ekspertët kanë hartuar disa rekomandime me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Më datë 15.04.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 121/9 Prot., datë 16.04.2024, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 19.04.2024, dhe me shkresë zyrtare Nr. 114/1 Prot., datë 19.04.2024, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.



GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.3, Kriteri 4, GVJ shprehet se, nga rishqyrtimi i dokumentacionit shoqërues konkretisht *Shtojca nr. 2. 3: Program Mësimor-Master TR, në programin mësimor të lëndës "Zhvillimi dhe Politika Turistike" në faqen e parë pasqyrohet vetëm nënshkrimin i miratimit nga dekani i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor*. Mbështetur në Nenin 76 të Rregullores së Përgjithëshme të KU "LOGOS" citohet se, "Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës (lektori) apo grup lektorësh, konsultohet në njësinë bazë përgjegjëse për programin përkatës të studimit dhe miratohet nga *përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit (ose dekanët e dy fakulteteve kur programi i studimit dhe disiplina përkatëse administrohet nga fakultetet të ndryshme)*. Në zbatim të kësaj rregulloreje mungon nënshkrimi i miratimit nga përgjegjësi i departamentit që administron programin dhe duke mbajtur në konsiderat se ky program ofrohet në bashkëpunim edhe me Departamentin e Menaxhimit të Fakultetit Ekonomik të KU "LOGOS" në syllabus mungon nënshkrimi i miratimit edhe të dekanit të Fakultetit Ekonomik si kundër citohet më sipër në këtë rregullore. Mbështetur në sa më sipër, GVJ nuk ndryshon konstatimin, por shton se në zbatim të rregullores, krahas miratimit të përgjegjësit të departamentit të nënshkruhet edhe miratimi i dekanit të Fakultetit të Ekonomisë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.1, Kriteri 1, GVJ rishqyrtoi tabelat dhe konstaton të njëjtin problem. Në tabelën Nr.10.2 gjejmë mospërputhshmëri të totalit të orëve të disiplinës "praktikë" në kolonën "Gjithsej" (120 orë në auditor dhe 180 orë studim individual = 300 orë) me totalin e orëve të disiplinës "Praktika" në rreshtin "Total" të cilat janë 120 orë. Pra diferenca e orëve që mungojnë në rreshtin "Total" në Praktikë në terren është prej 180 orësh. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.4, Kriteri 1, GVJ verifikoi edhe një herë tabelën e të dhënave me anëtarët e NJSBC-së dhe rezulton që IAL ka përfshirë një ekspert të jashtëm në të. Prandaj **Raporti në këtë pikë ndryshon.**




**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Turizëm Religjioz”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Kolegji Universitar “Logos” (KU “LOGOS”) është një institucion privat i arsimit të lartë, jofitimprurës i hapur me VKM-në Nr.1055, datë 29.07.1999 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr 59, datë 16.12.2021, për një afat 5 vjeçar, deri më 15.12.2026.</p> <p>Programet që ofron, nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit. Programi Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, pasi është hartuar në përputhje me Legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>[Ref. Ligji nr. 80/2015 datë 22.7.2015, Shtojca nr. 1.1: Statuti i KU “Logos”, neni 3; Shtojca nr. 1.3: Rregullore e FSHHKGJ, Shtojca nr. 1.4: Rregullore e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës; Vendimi i Bordit të Akreditimit].</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Bazuar në statutin dhe rregulloren e Kolegji Universitar “Logos” (KU “LOGOS”), programet e ofruara, synojnë përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme dhe janë në përputhje me qëllimin, objektivat si dhe fushën e veprimtarisë së këtij institucioni.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.1: Statuti I KU logos, neni 3; Shtojca nr. 1.2: Rregullore e përgjithëshme e KU LOGOS; Shtojca nr. 1.3: Rregullore e FSHHKGJ, Shtojca nr. 1.4: Rregullore e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës].</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>KU “LOGOS” ka fokusuar veprimtarinë e tij në tri drejtime kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. shkencave humane dhe komunikimit, 2. shkencave ekonomike, 3. shkencave shkencave të aplikuara, <p>Ky program studimi është hartuar në kuadrin e këtyre drejtimeve dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 5.1: Plani strategjik KU “Logos” 2018-2024, Shtojca nr. 5.2: Plani strategjik i departamentit 2022-2025].</i></p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur për studimin e tregut para licensimit të programit si dhe në RVB e paraqitur nga institucioni, theksohet që për hartimin e programit të studimit është bazuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Startegjinë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit; 2. Raportet e publikuara nga INSTAT për Turizmin në Shqipëri; 3. Raportet e Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC) <p>Nga shqyrtimi i dokumenteve të sipërpërmendura theksohet nevojat e tregut për specialistë dhe ekspertë të industrisë së turizmit si dhe në përputhje me kërkesat dhe prioritetet me interes kombëtar në mënyrë specifike udhërrëfyese turistik me tematikë turizmin religjioz.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 5.2: Plani strategjik i departamentit 2022-2025; Shtojca nr. 4.2. Seksioni A Të dhëna mbi programin e studimit].</i></p> <p><i>Për të plotësuar studimin e tregut aktual edhe perceptimet e përfaqësuesve të zinxhirit të shërbimeve turistike në Shqipëri, GVJ sugjeron realizimin e një studimi të mbështetur në intervista dhe anketimeve të grupeve të interesit në lëmin e turizmit në vend.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se Institucioni i Arsimit të Lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>KU "LOGOS" dëshmon se kapacitetet e veta infrastrukturore dhe njerëzore për ofrimin e programeve cilësore i ka të forcuara. Koherenca në treg, përpjekjet cilësore për përmirësimet e vazhdueshme të programeve ekzistuese dhe lançimin e programeve të reja inovative, qasjet inovative për tërheqjen e sa më shumë studentëve, përpjekjet për të gjeneruar dhe përmirësuar ndjeshëm cilësinë e mësimit dhe mësuesit, përfshirja intensive e studentëve sikurse përpjekjet cilësore për të rritur jetën sociale brenda universitetit, lidhja me tregun, marrëveshjet efiçente me bizneset dhe institucionet e tjera janë disa nga treguesit e përgjithshëm të identifikuar dhe çertifikuar ndjeshëm në këtë dekadë. Fakulteti dhe njësia bazë në të cilën bën pjesë programi i studimit</p>




	<p>dëshmojnë se disponojnë burimet e nevojshme njerëzore, të cilët janë të përfshirë në mësidhënien e këtij programi studimi.</p> <p>Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni rezulton se për vitin akademik 2021-2022, në programin e studimit janë angazhuar në total 11 pedagogë, nga të cilët 2(dy) Prof. Asoc. Dr, 8(tetë) me gradën PhD/Dr dhe 1(një) Dr.në proces, të gjithë me përvojë të gjatë akademike dhe profesionale.</p> <p>Ndërsa për vitin akademik 2022-2023, në programin e studimit janë angazhuar në total 15 pedagogë, nga të cilët 1(një) Prof.Dr., 4(katër) Prof. Asoc. Dr. dhe 10(dhjetë) me gradën PhD/Dr.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 21.2 Tabelat 6.1 dhe 6.2 si dhe Tabelat 19 dhe 20 të tabelave përmbledhëse; Shtojca nr. 23 Marrëveshje me MAS reduktimi i numrit të personelit akademik në njësinë bazë; Shtojca nr. 7.6.1 Cv-të e stafit akademik].</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumtacioni dhe RVB konstatohet se program i studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” është program ndërdisiplinor në të cilin kompetencat lëndore janë të ndërthurura ndërmjet Besimit, Turizmit dhe Historisë. Duke qenë se dy të parat janë dominate në kurrikul, justifikon edhe ofrimin e këtij program nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës në përputhje kjo edhe me Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Gjithashtu edhe nga takimet e zhvilluara me dekanin dhe drejtuesin e njësisë bazë gjatë vizitës në institucion u argumentua se fakulteti si njësi kryesore dhe përmbledhëse e disa programeve përkatëse është munduar të ndërthurë dhe të ofroj një model programi ndërdisiplinor duke u mbështetur edhe në eksperiencat rajonale, në rastin konkret kulturën, besimin në shërbimit të turizmit dhe shërbimeve turistike.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave “Turizëm Religjioz” ofrohet nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës, pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.</p> <p>Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor përbëhet nga 3 (tre) departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës, - Departamenti i Gjuhëve dhe Letërsisë, - Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë. <p>Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës ofron këto programe studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bachelor në “Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”; - Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” <p>Departamenti i Gjuhëve dhe Letërsisë ofron këto programe studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bachelor në “Gjuhë dhe Civilizim Grek”; - Master i Shkencave në “Përkthim Profesional”




	<p>Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë ofron këto programe studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; - Bachelor në “Punë Sociale” <p>Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore . GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” është organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit duke respektuar kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuqi për IAL.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi kategorizohet në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve; • Emërtimi përputhet me fushën specifike të studimit; • Strukturohet në 4 semestra akademikë (secili me 30 ECTS); • Në ndarjen e lëndëve janë respektuar kriteret ligjore në fuqi (VKM 41 datë 24.01.2018); • Lëndët e programit të studimit janë të koduara sipas përcaktimeve ligjore <p><i>[Ref. Shtojca nr. 28.6. Shkresë për MAS me propozimet për kodifikimin e programeve të studimit në KU LOGOS].</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” është program ndërdisiplinor i hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Ai është regjistruar si program i ciklit të dytë të studimit, Master i Shkencave, niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Referuar Shtojcës Nr.1 për fushat e detajuara të arsimit dhe trajnimit të Vendimit Nr. 310, datë 11.5.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” përfshihet në fushën e gjerë dhe fushën e ngushtë “Shërbime Personale” në të cilën përfshihet turizmi, udhëtimi dhe koha e lirë.</p> <p>Përgjegjës për administrimin e programit është Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës, i cili mbulon dhe shumicën e lëndëve të kurrikulës së programit të cilat janë histori dhe besim. Departamenti me të cilin bashkëpunon është Departamenti i Menaxhimit të Fakultetit Ekonomik në KU “LOGOS”. Ky departament ofron ekspertizën shkencore dhe didaktike në fushën e turizmit. Ky gërshetim njohurish reflekton përputhje të fushës së përgjithëshme dhe asaj specifike në përputhje si me fushën akademike të njësisë ofruese por edhe të asaj bashkëpunuese.</p> <p>Kjo simbiozë njohurish rrit rëndësinë dhe vlerën e programit të studimit në tregun turistik shqiptar dhe pasuron ofertën turistike me një tematikë të veçantë dhe të pa lëvruar më parë të lëvizjes turistike në Shqipëri.</p> <p>Në përfundim të këtij program studimi lëshohet Diplomë për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave.</p>





	<p>[Ref. Shtojca nr.2.2 Plan Mësimor; Shtojca nr. 2.3 Program Mësimor; Shtojca nr.28.6. Shkresë për MAS me propozimet për kodifikimin e programeve të studimit në KU LOGOS; Shtojca nr. 28.2 VKM nr.288, 11.05.2022 Miratim i Kodifikimit ndërkombëtar; Shtojca nr.28.3 Vendim nr. 310 dt. 11.05.2022].</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Nuk është e aplikuar në këtë IAL.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit dhe RVB konstatohet që brezi i parë i studentëve të diplomuar në këtë program studimi doli në përfundim të vitit akademik 2022-2023.</p> <p>Gjatë vizitës në instiucion, në takimin me studentët prej tyre u konfirmua se një numër i konsiderueshëm prej tyre janë të punësuar pranë Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, institucioni që financon programin e studimit.</p> <p>Përveç kësaj KU “LOGOS” dëshmon për një sërë marrëveshesh efektive me partnerë vendas dhe të huaj për zhvillimin e praktikave, projekteve, trajnimeve të formimit profesional të vazhduar në kuadër të Forumit të Turizmit Religjioz të cilat u ofrojnë mundësi studentëve të trajnohen dhe kualifikohen në tregun e punës.</p> <p>[Ref. Shtojca nr. 22.2. Marrëveshje me Instiucionet dhe Organizatat bashkëpunuese].</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të</p>	<p>Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda departamentit</p>




<p>frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit akademik. Duke mbajtur në konsiderat se kjo njësi bashkëpunon me Departamentin e Menaxhimit të Fakultetit Ekonomik të KU "LOGOS" për zhvillimin e këtij program studimi rezulton se marrja e përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre kryhet në sinkron edhe me drejtuesen e Departamentit të Menaxhimit. Mbështetur në dokumentacionin shoqëruar dëshmohet se në zhvillimin e analizave të punës marrin pjesë edhe personel akademik të Departamentit të Menaxhimit, të cilët kontribuojnë në program duke dhënë mendimet dhe sygjerimet për çështjet e trajtuara nga Përgjegjësi i Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës.</p> <p>GVJ e konfirmoi frymën e bashkëpunimit në shkëmbimin e mendimeve dhe sygjerimeve edhe gjatë vizitës që zhvilloi në institucion.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 25.2: Raporte të takimeve me stafin; Minutat e takimit-Vizita në institucion].</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni dhe njësitë përbërëse të tij kanë një listë me marrëveshje të realizuara me kompani apo institucione të ndryshme në funksion të realizimit të praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>Edhe për programin e studimit Master i Shkencave në "Turizëm Religjioz" ekzistojnë një numër i madh marrëveshjesh për zhvillimin e praktikës profesionale. Nga këto marrëveshje, GVJ vlerësoi faktin, që ato çojnë në atë nivel që studentët kryejnë praktikën konkretisht në institucione religjioze që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat lëndorë të programit.</p> <p>Gjarë vizitës në instucion, GVJ, në takimin me studentët u njoh konkretisht me faktin që studentët ende pa përfunduar këtë cikël studimi ushtronin profesionin e udhërrëfyesit religjioz në disa institucione të besimit orthodhoks e myslyman.</p> <p><i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 22.2: Marrëveshje me institucionet dhe Organizata bashkëpunuese; Shtojca nr.26.12: Vendim i përbashkët Departamenti i Teologjisë-Menaxhimit, Plani i Aktiviteteve, Java e trajnimeve].</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe</p>	<p>Nuk është e aplikuar në këtë IAL</p>


mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.				
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Departamenti kryen analizave vjetore në të cilat merren në hollësi një sërë çështjesh, ndër të cilat dhe ajo e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Analiza e përvitshme e punës mësimore dhe shkencore që departamenti realizon, trajton në detaje kontekstin e bashkëpunimit të personelit akademik dhe të aspekteve pozitive që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka ky program.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 5.3: Raporti i departamentit 2020-2021].</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. Njësia bazë ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunuese dhe është në zgjerim të vazhdueshëm të bashkëpunimit me institucione dhe organizata fetare dhe industrinë dhe organizatat, që merren me fushën e turizmit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Pas shqyrtimit të planit mësimor të programit të studimit të paraqitur nga institucioni, takimeve të realizuara gjatë vizitës në KU “LOGOS” konkludojmë se programi është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në përfundim të studimeve të tyre, studentët e këtij programi grumbullojnë 120 ECTS.</p> <p><i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 2.2: Plani Mësimor TR].</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Ky program studimi përbën një përpjekje për të furnizuar studentët me dije, njohuri dhe ekspertizë të konsiderueshme profesionale e aplikative, për një punësim të sigurt dhe punë të kualifikuar.</p> <p>Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së lëndëve, metodave të mësimdhënies, detyrave të kursit, praktikave profesionale jashtë institucionit synohet që tu jepet studentëve njohuri të përparuar akademike dhe shprehje praktike në fushën përkatëse të studimit (turizëm), si dhe koncepte të të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p>Ky program studimi është konceptuar për pajisur studentët me dijen dhe shprehitë profesionale që do t’i ndihmojë ata të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve konkrete të realitetit.</p> <p><i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 2.2: Plani Mësimor TR; Shtojca nr. 2.3: Program Mësimor Master TR].</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në planin mësimor të programit të studimit, janë përcaktuar kreditet për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, të cilat ndodhen respektivisht: Praktika në kategorinë D dhe ka 12 ECTS ndërsa detyrime përmbyllëse në kategorinë E dhe ka 18 ECTS.</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve “Rregulloren e praktikës” dhe “Rregulloren e Diplomimit për MsC TR” në këto dokumente studentët gjejnë detyrimet dhe të gjithë modalitetet ndihmëse për zhvillimin e praktikës dhe shlyerjen e detyrimit përmbyllës.</p>




13


	<i>[Ref. Shtojca nr.2.4: Rregulloren e Praktikës të MsC Tr; Shtojca nr.13.2: Rregulloren e Diplomimit për MsC Tr; Shtojca nr.13.3: Rregullorja për tezën e Diplomës së Masterit].</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Pas diskutimit edhe në institucion me stafin dhe drejtuesin e departamentit, gjykohet se forma e organizimit të studimeve në këtë program studimi, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin, por edhe në aktet rregullatore të institucionit. <i>[Ref. Neni 84 i ligjit të arsimit të lartë].</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	KU “LOGOS” është unik në një numër të konsiderueshëm programesh studimi që ofron. Ndër to është edhe programi i studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” pjesë e Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës. Një program i tillë nuk gjendet në Institucionët e tjera të Arsimit të Lartë (IAL), si në ato publike, ashtu edhe në ato private. Për sa më sipër nuk kemi të dhëna që të ketë një program tjetër të ngjashëm për të bërë të mundur për të gjykuar përmbajtjen e përbashkët e cila duhet të jetë së paku 70%. <i>[Ref. Vizita në institucion, RVB fq. 19].</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria	Në lidhje me kodifikimin e programit të studimit, institucioni ka bërë propozimin përkatës dhe pritët përgjigja nga ministria përgjegjëse, në vijim të VKM-së 310, datë 11.05.2022.

përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	<i>[Ref. RVB fq. 20; Shtojca nr. 28.6: Shkresë për MAS për propozimet për kodifikimin e programeve KU LOGOS; Shtojca nr. 28.7: Vendim SA nr. 2 dt.04.02.2020 për kodifikimin e programeve].</i>		
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi		
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor përbëhet nga tri departamente.</p> <p>Departamentet, pjesë e strukturës së FSHHKGJ-s janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Gjuhëve dhe Letërsisë; 2. Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë; 3. Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës• <p>Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës si përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Referuar rregullores së programit të studimit, planit mësimor dhe RVB:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi i studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” është program i ciklit të dytë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. • Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kritereve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 datë 24.01.2018. • Programi organizohet në formën e studimit me kohë të plotë. • Kohëzgjatja e studimeve është 2 vite akademike/4 semestra. • Vlerësimi në kredite: 120 ECTS (3000 orë) të ndara 60 ECTS për vit akademik (1500 orë).




	<ul style="list-style-type: none"> • 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit. • Raporti ECTS:orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 7.5 - 10/15 – 17.5 orë në auditor/orë studimi individual). Kohëzgjatja e orëve të mësimi është 50 minuta. • Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module të ndara në kategori dhe të prezantuara në planin mësimor dhe tabelat e RVB. • Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimi teorik, (leksione, seminare) dhe praktik (laboratorë, praktikë profesionale). Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në: <ul style="list-style-type: none"> A. Lëndë bazë B. Lëndë karakterizuese C. Lëndë ndërdisiplinore/ integruese D. Lëndë plotësuese E. Detyrime përmbyllëse dhe diploma <p><i>[Ref. Shtojca Tabela nr. 2.1 dhe nr.2.2 të tabelave mbështetëse; RVB fq. 21; Shtojca nr. 23: Marrëveshje MAS, Reduktimi i numrit të personelit akademik në njësinë bazë].</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës përbëhet nga 7 (shtatë) personel akademik me kohë të plotë. Ky departament përveç personelit akademik të brendshëm ka edhe personel akademik me kontratë, numri i të cileve në vitin akademik 2022-2023 është gjashtëmbëdhjetë, të cilët janë rekrutuar në përputhje me kriteret dhe nevojat e përcaktuara.</p> <p>Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës, i plotëson kushtet për numrin e personelit akademik me tituj dhe grada që janë të përfshirë në strukturën e tij. Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës ka më shumë se pesë persona me tituj dhe grada Në mënyrë më të detajuar personeli akademik është si më poshtë:</p> <p>Viti akademik 2022-2023:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1- Prof.Dr.; 3- Prof.Assoc.; 12- PhD/Dr.; 1- Dr. në proces; 1- Msc; <p>Në total numi i personelit akademik në këtë departament është 7 (shtatë).</p> <p><i>Referuar RVB-së departamenti ka edhe një person staf administrativ ndihmës i cili kryen edhe funksionin e sekretares për studentët e këtij departamenti e një bibliotekar departamenti, por ky informacion nuk konfirmohet në tabelat përmbledhëse që i paraqiten ASCAL.</i></p>

	<i>[Ref. 6-Tabelat 1-24 përmbledhëse për Aneks RVB; RVB].</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Turizëm Religjioz" ka një koordinator i cili është përgjegjësi i departamentit. Koordinatori i programit të studimit, është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. <i>[Ref. Vizita ne institucion, RVB fq. 23].</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në lidhje me standardet, përgatitjen, organizimin dhe administrimin e këtij programi studimi, shtylla kryesore është rregullorja e njësisë kryesore. Të gjitha njësitë bazë të FEA-s, harmonizojnë rregulloret e programeve të studimeve të tyre si edhe veprimtarinë në përputhje me këtë rregullore. Ato mund të vendosin kriteret shtesë, por ato nuk duhet të jenë në asnjë rast më të ulëta ose me minimale se kriteret bazë të kësaj rregullore. Programi i studimit Master i Shkencave në "Turizëm Religjioz", funksionon në bazë të rregullores së veçantë të këtij programi studimi, të vitit 2021. <i>[Ref. Shtojca nr. 1. 3: Rregullore e FSHHKGJ; Shtojca nr. 1. 4: Rregullore e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës].</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bazuar në takimet me drejtuesin e departamentit dhe materialet shtesë të vëna në dispozicion, programi i studimit është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor, i cili jep informacion të detajuar në lidhje me llojin e veprimtarisë, numrin total të krediteve për çdo lëndë, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Ndërkohë, në rregulloren e akademike të institucionit si dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohen


	<p>rregullat për frekuentimin e mësimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj.</p> <p>Programi zhvillohet në 2 vite akademike, 4 semestra dhe ka në total 120 ECTS ose 3000 orë mësimore prej të cilave 1200 orë në auditor dhe 1800 orë studimi individual.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 2. 2: Plani Mësimor TR; VKM nr. 41, 2018, e ndryshuar]. Tabela 10.1 nga Tabelat përmbledhëse 1-24.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e njësisë kryesore, të programit të studimit dhe rregulloren e transferimeve gjenden, të gjitha informacionet e nevojshme për studentet, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit si dhe ekuivalentimin e studimeve. Brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, departamenti u bënë të njohur studentëve kurrikulën e studimeve për të dyja vitet e studimit. Kjo kurrikul është e projektuar në mënyrë të tillë, që studentët në përfundim të ciklit të studimeve jo vetëm të jenë të aftë të konkurrojnë në tregun e punës, por të kenë mundësi që të mund të ekuivalentojnë studimet në rast se dëshirojnë që të studiojnë edhe në ndonjë program tjetër studimi. Grupi i vlerësimit nuk gjeti ndonjë praktike të ekuivalentimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.3: Rregullore e FSHHKGJ; Shtojca nr. 1. 4: Rregullore e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës; Shtojca nr. 26. 3: Vendim Departamenti i Teologjisë Vendimi për Kriteret e Pranimit të Studentëve 2023-2024; Shtojca nr.19. 3: Rregullore e Transferimeve].</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet lëndore janë hartuar në bazë të legjislacionit në fuqi. Syllabusi i çdo lënde përmban titullin e lëndës emrin e personelit akademik që është titullar i lëndës, tipologjinë e lëndës (<i>formim i përgjithshëm, karakterizues etj</i>), llojin e lëndës (<i>e detyrueshme apo me zgjedhje</i>), kodin e lëndës , adresën elektronike të titullarit të lëndës, rezultatet e të nxëniet të pritëshme nga ana e studentit, konceptet themelore të modulit, lista e temave të detajuara, së bashku me literaturën bazë, format e kontrollit të vazhdueshëm dhe përfundimtar të dijeve dhe literaturën e rekomanduar.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i Syllabuseve GVJ konstaton se në literaturën e detyruar jepet një numër i gjerë librash (referencash burimore) dhe njëherazi edhe cikli i leksioneve i përgatitur nga personeli akademik titullar i lëndës. Kjo e konfuzon studentin dhe e shpërndan atë. Për këtë rekomandojmë që si literaturë e detyruar të jetë jo më shumë se dy burime dhe pjesa tjetër të përfshihet në literaturë të rekomanduar. Gjithashtu në syllabusin e lëndës Zhvillimi Turistik Lokal si literaturë e detyrueshme paraqitet cikli i leksioneve i përgatitur nga titullari i lëndës ndërsa në përshkrimin e temave në brendi të syllabusit për tema të ndryshme ka referenca burimore të ndryshme, pra konstatohen mospërputhje.</i></p>




	<p><i>Duke mbajtur në konsideratë që program mësimor përmirësohet në çdo vit akademik sugjerojmë që në syllabus të përcaktohet viti akademik në të cilin është zbatuar ky program mësimor (në faqen e dytë ku jepen të dhënat e përgjithshme të programit, jo në faqen ku është bërë miratimi nga dekani), me qëllim edhe analizimin e efekteve që sjellin përmirësimet në syllabus nga viti në vit. Gjithashtu, në syllabuse, konstatohet në tema të ndryshme nuk shënohen faqet e materialit ku gjendet përmbajtja e kësaj teme, për këtë rekomandohet plotësimi me nr. e faqeve ku gjendet përmbajtja e kësaj teme sipas përcaktimeve në VKM nr. 41, 2018, e ndryshuar.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që miratimi i syllabuseve të kryhet nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe jo nga drejtuesi i njësisë kryesore, pasi ai është përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit dhe nga dekani i Fakultetit të Ekonomisë në bashkëpunim me të cilin është ky program.</i></p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 2. 3: Program Mësimor-Master TR].</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Programi është në vitin e dytë të funksionimit dhe akoma nuk është parë e arsyeshme nga njësia bazë që ai të ketë përmirësime. Në takimin me koordinatoren e programit, na u tha që po presin dhe anketimet e fundvitit akademik dhe më pas në rast se do ketë nevojë, mund të ketë vend dhe për ndryshime.</p> <p><i>[Ref. Takimi në Institucion].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. GVJ rekomandon rishikimin e klasifikimit të literaturës së detyruar dhe të rekomanduar, përditësimin dhe pasurimin e literaturës dhe plotësimin e nr. të faqeve të literaturës për çdo temë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave,</p>	<p>Tërësia e moduleve të përfshira në këtë program studimi, përmbajtja e tyre, është në funksion të krijimit të njohurive dhe aftësive në fushën e turizmit,</p>

<p>mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>kulturës dhe besimit në funksion të zhvillimit të turizmit religjioz në përgjithësi, zhvillimit të produktit turistik dhe pelegrinazhit në veçanti, me fokus menaxhimin e turizmit religjioz dhe në mënyrë specifike të pelegrinazhit që zhvillohet në objektet e kultit, kryesisht në zonat e besimit orthodhok dhe jo vetëm. Duke analizuar planin mësimor, silabuset dhe kurrikulën në përgjithësi, mund të themi se përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabelat nr. 14.1 dhe 14.2 të tabelave mbështetëse; Shtojca nr. 2. 3: Program Mësimor-Master TR].</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe vite është bërë në mënyrë të tillë që të mund të arrihen objektivat e studimit në këtë program. Në këtë rast, programi i studimeve Master i Shkencave në "Turizëm Religjioz" është formatuar i tillë që jo vetëm të mundësojë arritjen e objektivave formues të programit të studimit, por dhe rezultate të pritshme të të nxënit.</p> <p><i>[Ref. RVB fq. 26].</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Referuar planit mësimor, është bërë një shpërndarje e lëndëve me qëllim një raport të balancuar teori me praktikën por dhe rritjen e nivelit të formimit profesional dhe që vazhdimisht do të jetë në përmirësim duke iu përshtatur kërkesave të kudrit rregullator. Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabelat nr. 14.1 dhe 14.2 të tabelave mbështetëse; Shtojca nr. 2. 3: Program Mësimor-Master TR].</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Shpërndarja sipas veprimtarive të formimit teorik dhe praktik i cili mundëson artitjen e objektivave formues dhe ndikimin në punësim të studentëve është realizuar sipas legjislacionit në fuqi. Procedura e transferimeve brenda programeve të KU "LOGOS" por edhe midis universiteteve të ndryshme rregullohet nga rregullorja e studimeve në KU "LOGOS". Ky program studimi nuk kishte ndonjë praktikë transferimesh.</p> <p><i>[Ref. Evidencë 3, Rregullore Studime Universitare, VKM nr. 41, 2018, e ndryshuar, Rregullore e studimeve, Evidencë nr. 72 plani mësimor 2021-2022].</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën</p>	<p>Shih Kriterin 4: Standarti II.3</p>




bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.									
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit garanton dhe është në përputhje të plotë me përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi. Fokusi i studimit të programit Master i Shkencave në “Turizëm Religjöz” është marrja e njohurive të thelluara në fushën e turizmit dhe regjiliozitetit dhe përmbajtja e programit ofron fitimin e njohurive dhe kompetencave të synuara. <i>[Ref. Shtojca: Tabelat nr. 14.1 dhe 14.2 të tabelave mbështetëse; Shtojca nr.2. 3: Program Mësimor-Master TR].</i>								
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ konstaton se ka një program mentorimi të strukturuar mbi të cilën të udhëhiqen studentët në karrierën e tyre, siç kemi konstatuar më sipër. IAL disponon lista të rregullta të çdo studenti deri në procesin e punësimit të tyre. Programi u mundëson studentëve vijimin e karrierës së tyre profesionale dhe punësimin në industrinë e turizmit. <i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 4.2: Seksioni F Analiza e tregut të punës; Shtojca nr. 3 Rregullore e programit të studimit MSC TR, neni 4].</i>								
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. GVJ rekomandon rishikimin e klasifikimit të literaturës së detyruar dhe të rekomanduar, përditësim dhe pasurimin e literaturës dhe plotësimin e numrit të faqeve të literaturës për çdo temë.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.5


Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë	Programi është në vitin e dytë të funksionimit dhe akoma nuk është parë e arsyeshme nga njësia bazë që ai të ketë përmirësime. Në takimin me koordinatoren e programit, na u tha që po presin dhe anketimet e fundvitit dhe më pas në rast se do ketë nevojë, mund të ketë vend dhe për ndryshime.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



21



përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<i>[Ref. Takimi ne institucion].</i>			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga takimet me studentet e këtij programi studimi, na u transmetua që ata janë të përfshirë në shumë çështje që kanë të bëjnë me programin e studimit nën vlerësim. <i>[Ref. Takimi me studentet; Vizita në institucion].</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Programi është në vitin e dytë të funksionimit dhe akoma nuk është parë e arsyeshme nga njësia bazë që ai të ketë përmirësime. Në takimin me koordinatorin e programit dhe përgjegjësin e njësisë bazë na u tha që po presin dhe anketimet e fundvititi dhe më pas në rast se do ketë nevojë, mund të ketë vend dhe për ndryshime. <i>[Ref. Takimi ne institucion; Vizita në institucion].</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit, thekson se programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor. Pjesë e veprimtarive mësimore në fushën përkatëse është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit, projekteve të ndryshme dhe përdorimit të literaturës bashkëkohore. <i>[Ref. Shtojca nr. 5.1 Plani Strategjik i Ku LOGO-s 2018-2024; Shtojca nr. 5.2 Plani Strategjik i Departamentit 2022-2025].</i>




<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Në takimet me drejtuesin e njësisë kryesore/njësisë bazë konstatojmë se njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. FSHHKGJ-si njësia kryesore për vetë natyrën e tij zhvillon shumë aktivitete të karakterit artistik dhe rekreativ por edhe të natyrave të tjera që kanë të bëjnë me mësim-dhënien dhe kërkimin shkencor dhe Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës nxit anëtarët e saj të marrin pjesë në këto aktivitete, veçanërisht në leksione të hapura apo projekte kërkimore me karakter aplikativ.¹</p> <p><i>[Ref. Takimi në institucion medrejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë].</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet në KU “LOGOS” në parim rezultojnë që programi i studimit nxit dhe motivon studentët të përfshihen në studime dhe projekte apo aktivitete kërkimore, nga vetë natyra e programit të studimit. Personeli akademik mësimdhënës, por dhe strukturat e tjera organizative, mundohen ta përfshijnë studentin në procesin e kërkimit shkencor nëpërmjet detyrave, diplomave si dhe përfshirjes në zbatimin e projekteve të ndryshme që njësia zbaton në bashkëpunim edhe me revistën “Fjala” dhe në blogun e udhëtimeve “Travel in Albania” ku paraqiten të gjithë rrugët e pelegrinazhit dhe qendrat religjioze të Shqipërisë. Ky blog menaxhohet nga studentët pasuniversitar të këtij programi si pjesë e përmbushjes së praktikës mësimore në fushën e turizmit religjioz.</p> <p><i>[Ref. RVB fq. 33; GVJ hyri në këtë faqe dhe konstatoi punët e kryera nga studentët].</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Për realizimin e aktiviteteve me karakter kërkimor rezultoi se njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. Në KU “LOGOS” administrimi i të ardhurave nga aktivitete apo projekte kërkimore realizohet në nivel institucional. Administratori i KU “LOGOS” drejton, ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor dhe veprimtarive financiare të institucionit dhe në të gjitha strukturat e varësisë së tij.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 5.1 Plani Strategjik i Ku LOGO-s 2018-2024; Shtojca nr. 6.6 Mbështetje për Departamentin në kuadër të publikimit të teksteve].</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Por GVJ sugjeron që stafi të ketë një mbështetje më të madhe financiare nga ana e institucionit.</i></p>

¹ <https://fshsts.umb.edu.al/kerkimi-shkencor.html>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit konkluduar se një nga shtyllat e veprimtarisë së tij KU "LOGOS" ia ka dedikuar punës kërkimore shkencore. KU "LOGOS" ka të ngritur strukturën Forumi i Turizmit Religjioz. Forumi është një platformë aktivitetesh që ka për qëllim zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta në funksion të promovimit, krijimit e modelve të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit religjioz në bashkëpunim midis akademikëve, agjensitë publike, private dhe përfaqësive diplomatike në vend. <i>[Ref. RVB fq. 34 dhe Takimi në Institucion].</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga takimet konkluduar se njësia bazë bashkëpunon ngushtësisht me njësitë e tjera të KU "LOGOS" për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me fokus Turizmin Religjioz. Disa prej anëtarëve të këtij departamenti angazhohen në projekte kërkimore aplikative dhe janë pjesë e tyre e grupeve të punës në projekte kërkimore aplikative ku institucioni është lider dhe partner. Kjo mundëson që personeli akademik të pasurojë eksperiencën e vet akademike, por dhe të ndihmojë studentët të përfshihen në këto projekte. <i>[Ref. Shtojca nr. 8 Politikat e Zhvillimit të Stafit Akademik; Shtojca nr. 10 Politika e Zhvillimit të Stafit Akademik].</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në takimet me stafin dhe studentët e këtij programi u evidentua se Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. <i>[Ref. Shtojca nr. 26.5 Vendim Departamenti i Teologjisë Forumi i Turizmit Religjioz,; Shtojca nr. 30.2 Programi i Forumit Religjioz KU LOGOS (5 nëntor 2022)].</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Në takimet me studentët e programit të studimit u konstatua se ky program studimi formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Studentët janë të punësuar në sektorin e turizmit dhe të përgatitur për tregun e punës. <i>[Ref. Shtojca 30.4: Aktivitete të ndërrmara nga programi në kalendarin e AKT; RVB].</i>

<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Nga takimi me drejtuesin e njësisë kryesore si dhe përgjegjësin e njësisë bazë, u shprehën se njësia bashkëpunon me agjensitë e udhëtimit në vend për të vjelë rekomandime për zhvillimin e kompetencave profesionale për studentët e Masterit Shkencor “Turizëm Religjioz”. Konkretisht me Elite Travel Group ku shtudentë janë orientuar në përmbushjen e kërkesave për udhërrëfyesin turistik.</p> <p><i>[Ref. RVB; Takimi me studentët gjatë vizitës në institucion].</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se program i studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. Ai u jep mundësinë studentëve të punësohen në sektorin e turizmi, të zhvillojnë shërbime dhe produkte turistike.</p> <p><i>[Ref. Shtojca 4.2: Seksioni F Analiza e tregut të punës; RVB].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--



25



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit si dhe takimeve gjatë vizitës në IAL duke iu referuar edhe planit mësimor, identifikon se format e përdorura të mësimdhënies janë: leksionet, seminarët, projektet/ detyrat e kursit, praktika dhe udhëzimet për provimin e përgjithshëm përfundimtar/ diplomën.</p> <p>Ndarja e tyre është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Leksione – 150 orë në auditor/225 studim individual 2. Seminare – 265 orë në auditor /397.5 studim individual 3. Ushtrime- 10 orë në auditor /15 studim individual 4. Laboratore-55 orë në auditor /82.5 studim individual 5. Praktika profesionale në terren-120 orë Shtojca 6 Tabelat 1-24 përmbledhëse për Anex_RVB, tabela 10.2 <p>Pas kontrollit të totalit të orëve rezulton se numri i përgjithshëm i tyre nuk është 1500 orë por 1320 orë. Kjo mund të jetë edhe gabim njerëzor në hedhjen e të dhënave.</p> <p>Gjithashtu realizimi i sesioneve të hapura dhe komunikimi i studentit me personelin akademik mbahet i hapur edhe nëpërmjet platformës Neo LMS dhe EduPage.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 16.8 Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve].</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë takimit me personeli akademik dhe studentët u konstatua se personeli akademik mban kontakte të vazhdueshme me studentët e tij dhe ka zhvilluar forma ndërveprimi me ta, duke nxjerrë në pah aftësitë dhe cilësitë e gjithsecilit student, pa kursyer burimet e veta në dispozicion të diversitetit të studentëve, por, njëkohësisht, duke ruajtur edhe natyrën e veprimtarive formuese që ky program studimi ofron. Pedagogu është i hapur të argumentojë me fakte vlerësimin e studentit. Nëse studenti nuk është prezent, ai ka mundësi që më vonë të kërkojë vlerësimin individual në departament. Sekretaria informon studentët mbi vlerësimet që ata kanë marrë në lëndë të ndryshme gjatë vitit, por dhe në përfundim të semestrave. Nga institucioni theksi në mësimdhënie është vendosur në përdorimin e metodave inovatore dhe teknologjisë në mësimdhënie.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 16.2 Udhëzues për mësimdhënien novatore në IAL].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin</p>	<p>GVJ thekson se KU “LOGOS” mbështet personelin e tij akademik me ndihmë logjistike (kompjuter dhe pajisje të tjera plotësuese), me</p>




 26

<p>e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>trajtime informuese mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit për të mbërritur tek studentët. Këto trajtime kanë lehtësuar ndjeshëm përdorimin e formave të reja didaktike në shërbim të mësimnxënies dhe në arritjen e objektivave formues.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 16.2 Udhëzues për mësimdhënien novatore në IAL; GVJ konsatoi edhe realizimin e serive Educational Tips botimeve në lëmin e edukimit religjioz].</i></p> <p>https://theolkulogosalb.wordpress.com/2023/02/09/teaching-innovation/</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik efektiv rezulton se personeli akademik është plotësisht përgjegjës në lëmin e vet shkencor, duke qenë se është personel i formuar në institucionet arsimore më në zë vendase dhe të huaja dhe arrin t'i përcjellë dijet me përgjegjësi shkencore te brezi i ri nëpërmjet metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies</p> <p>Lektorët si dhe asistentë lektorë, përdorin metoda bashkëkohore ku ndërthurin pjesën e teknologjisë në mësimdhënie. GVJ konstaton se një pjesë e tyre janë specialistë të fushës së turizmit, të cilët janë më afër industrisë, duke ndikuar dhe në rritjen e mundësive të punësimit dhe aftësimit praktik të tyre.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 6.7.1 CV-të e stafit akademik; Shtojca: Tabelat 6.1, 6.2, 7 të Tabelace mbështetëse].</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ thekson se njësia bazë është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik. Vlerësimit bëhet nëpërmjet vlerësimit peer to peer mes kolegëve, pyetësorëve të studentëve që hartohen nga zyra e cilësisë, si dhe vlerësimet vjetore që bëhen nga përgjegjësi i njësisë bazë.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 11.3 Trajnime nga institucioni për mësimdhënien; Shtojca nr. 29.5 Trajnime për stafin akademik të organizuar nga KPGSC; RVB].</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e</p>	<p>GVJ konstaton se IAL organizon në mënyrë periodike trajnime me stafin akademik, kryesisht për metodat e reja dhe inovative në fushën e mësimdhënies. IAL disponon manualin mbi procedurat e mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të ndryshme për një mësimdhënie bashkëkohore, ai nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies referuar rezultateve të nxjerra nga proceset monitorim-vlerësim dhe vetëvlerësimi i vetë pedagogut të modulit. Krahas hartimit të manualit institucioni i mundëson personelit akademik edhe trajnime në fushën e</p>

metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p>mësimdhënies në bashkëpunim me universitete të huaja si Universiteti i Democritus të Trakës.</p> <p>Të dhënat e grumbulluara nga dokumentacioni shoqërues GVJ i konfirmoi edhe gjatë takimit me personeli akademik që shërben në këtë program studimi gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 11.3 Trajnime nga institucioni për mësimdhënien; Shtojca nr. 29.5 Trajnime për stafin akademik të organizuar nga KPGSC; RVB].</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka garantuar procesin e të nxëniet dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së përgjithshme të KU “LOGOS” konstatojmë se në kreun VII, neni 95, 96, 98 përcaktohen kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve dhe njohurive profesionale. Gjithashtu kjo konfirmohet edhe në nenin 18 të Rregullores së programit të studimit.</p> <p>Çdo fillim viti akademik studentët informohen nëpërmjet përgjegjësit dhe koordinators të departamentit mbi rregulloren e programit dhe jepen shpjegimet e duhura për çdo rast. Nga GVJ rezultoi se ekzistojnë procedura transparente të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit përsa i përket vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Mënyra e kontrollit të dijeve është e përcaktuar dhe në sylabusin e çdo lënde.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.2 Rregullore e Përgjithshme e KU LOGOS; Shtojca nr. 3 Rregullore e programit të studimit MSC TR].</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët informohen në detaje për mënyrën e vlerësimit të studentëve. Personeli akademik i angazhuara në programin e studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” i njohin studentët në fillim të modulit me sylabusin, në të cilin pasqyrohet mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të modulit.</p>





	<i>[Ref. GVJ konfirmoi gjatë takimit me studentët realizimin e ballafaqimit me syllabusin në fillim të çdo semetri nga personeli akademik përgjegjës për zhvillimin e lëndës].</i>													
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Kontrolli i vazhdueshëm i njohurive dhe dijeve të tyre vlerësohet: “Vlerësimi i studentit mund të përfshijë, por nuk kufizohet në të më poshtëme”: Kjo nënkupton që shpërnadrja e përqindjeve sipas zërave është në varësi të prioriteteve të titullarit të lëndës. Një prej skemave paraqitet si më poshtë: <table border="1" data-bbox="603 616 1342 788"> <thead> <tr> <th>Komponentët e vlerësimit</th> <th>Pesha (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm</td> <td>30</td> </tr> <tr> <td>Aktivizim në seminare dhe leksione</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar²</td> <td>50</td> </tr> <tr> <td>TOTALI</td> <td>100</td> </tr> </tbody> </table> <p>Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet gjatë gjithë kohës së zhvillimit të modulit. Format e vlerësimit të vazhduar janë me gojë, me shkrim ose të kombinuar.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.2.3 Programi Mësimor-Master TR].</i></p>				Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)	Provimi i ndërmjetëm	30	Aktivizim në seminare dhe leksione	20	Provimi përfundimtar ²	50	TOTALI	100
Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)													
Provimi i ndërmjetëm	30													
Aktivizim në seminare dhe leksione	20													
Provimi përfundimtar ²	50													
TOTALI	100													
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</i>													
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht										
				X										

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ thekson se në vlerësimin e dijes së studentit personeli akademik mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm si dhe në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, praktika, punë krijuese, punime të ndryshme dhe detyra kursi. Vlerësimit të vazhdueshëm gjatë semetrit i shtohet dhe vlerësimi përfundimtar. <p><i>[Ref. RVB; Shih Kriterin 3 të Standartit III.2].</i></p>

² Zhvillimi i provimit përfundimtar është i detyrueshëm, pavarësisht sasisë së pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë të vlerësimit.

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe mrisin transparencën.</p>	<p>KU “LOGOS” krahas vlerësimit “paper based test” dhe vlerësimit me gojë zbaton edhe vlerësim elektronik, që nënkupton hartimin, postimin dhe prezantimin/mbrojtjen e detyrës/projektit të kursit. Institucioni ka përdorur platforma dhe sisteme online si Neo LMS, Microsoft Teams dhe Education Page, ku janë të përfshira edhe module të vlerësimit elektronik. Në projektet për të ardhmen parashikohet të zgjerohet zbatimi i testimit online krahas proceseve të tjera të mësimdhënies.</p> <p><i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 16.8 Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve].</i></p>										
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni si dhe konfirmimi gjatë takimeve se procedura e vlerësimit përfundimtar mbështet në rregulloret e IAL. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Referuar syllabusit, kontrolli i vazhdueshëm i njofurive dhe dijeve të tyre vlerësohet:</p> <table border="1" data-bbox="608 882 1347 1055"> <thead> <tr> <th>Komponentët e vlerësimit</th> <th>Pesha (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm</td> <td>30</td> </tr> <tr> <td>Aktivizim në seminare dhe leksione</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar³</td> <td>50</td> </tr> <tr> <td>TOTALI</td> <td>100</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ajo që duhet të theksohet se shpërndarja e përqindjeve nga njëri komponent tek tjetri ndryshon nga njëri syllabus tek tjetri. Kjo sipas rregullores së KU “LOGOS” është në varësi të titullarit të lëndës. Provimi zhvillohet në praninë e dy pedagogëve, ku njëri është titullar dhe tjetri asistent. Si hartimi i testit përmbledhës, ashtu dhe protokollin i letës së vlerësimit firmosen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.2 Rregullore e Përgjithëshme e KU LOGOS; Shtojca nr. 3 Rregullore e programit të studimit Msc TR; Shtojca nr. 13.5 Tezë provimi i plotësuar dhe e vlerësuar shembull].</i></p>	Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)	Provimi i ndërmjetëm	30	Aktivizim në seminare dhe leksione	20	Provimi përfundimtar ³	50	TOTALI	100
Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)										
Provimi i ndërmjetëm	30										
Aktivizim në seminare dhe leksione	20										
Provimi përfundimtar ³	50										
TOTALI	100										
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i vazhduar i punës së studentëve zhvillohet gjatë gjithë vitit. Ata marrin komente dhe vlerësime për detyra kurse, projekte, prezantime, teste formuese shoqërohet me komente për studentin me qëllim që ai të kuptojë gjendjen dhe të nxitet për t’u përmirësuar. Për zhvillimin e testit përmbledhës zhvillohet paraprakisht seancë shpjeguese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara, zhvillohet me ta model testi final dhe rishpjegohen kriteret e vlerësimit. Të gjitha këto synojnë që studenti të përmirësohet në performancën që do të paraqesë dhe të jetë i vetëdijshëm për vlerësimin.</p>										

³ Zhvillimi i provimit përfundimtar është i detyrueshëm, pavarësisht sasisë së pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë të vlerësimit.





	<p>Në takimin që zhvilloi GVJ me studentët në ditët e vizitës në institucion, kryerja e kësaj praktike u konfirmua prej tyre. Gjithashtu studentët u shprehën të kënaqur dhe të facilituar nga zbatimi i kësaj praktike.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.2 Rregullore e Përgjithëshme e KU LOGOS; Shtojca nr. 3 Rregullore e programit të studimit Msc TR; Shtojca nr. 13.5 Tezë provimi i plotësuar dhe e vlerësuar shembull].</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në IAL, GVJ konkludon se salla ku zhvillohet provimi monitorohet nga departamenti dhe sekretaria. Nuk lejohet përdorimi i celularëve. Po ashtu nuk lejohet hyrja e individëve që nuk kanë lidhje me provimin. Kodi i etikës së IAL, rregulloret e të gjitha niveleve institucionale nuk e tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyrave.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.2 Rregullore e Përgjithëshme e Ku LOGOS; Shtojca nr. 3 Rregullore e programit të studimit Msc TR; Shtojca nr. 26.6 Vendim Departamenti i Teologjisë-Komision Mbikqyrës për provime].</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimet e studentëve dokumentohen në fletën e vlerësimit dhe në Regjistrin e Rezultateve Akademike. Procesverbali i vlerësimit semestral/vjetor plotësohet nga pedagogu/ pedagogët në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e provimit. Fleta e vlerësimit firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe Kryesekretarja.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.2 Rregullore e Përgjithëshme e Ku LOGOS; Shtojca nr. 3 Rregullore e programit të studimit Msc TR].</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në takimin pas realizimit të provimit, pedagogu i modulit deklaron rezultatin e provimit të studentët dhe pas dakordësisë, i regjistron të njëjtat në fletën e vlerësimit, me qëllim që t'u jepet mundësia studentëve të njihen paraprakisht me notat e vendosura.</p> <p>Në rast se studenti mendon se ka pasur gabim në llogaritjen e pikëve dhe të notës, ose gjatë shënimit të notës, ka të drejtë të kontaktojë pedagogun e modulit dhe të diskutojnë për vlerësimin. Nëse kërkesa e tij gjendet e justifikuar, bëhet ndryshimi i duhur sipas procedurës, para se nota të regjistrohet në sistem.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.2 Rregullore e Përgjithëshme e KU LOGOS neni 99, 101, 102; Shtojca nr. 3 Rregullore e programit të studimit Msc TR neni 19].</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së KU "LOGOS" (nenit 99), studenti ka të drejtën e ankimit për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Ankesa i parqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga marrja e komunikimit të notës pas përfundimit të modulit/lëndës. Drejtuesi i departamentit kryen dëgjuesën</p>




	<p>e lektorit të lëndë brenda 48 orëve dhe në rastin kur nuk gjejnë zgjidhje kërkon dhe ngre një komision Ad hoc. Në komision marrin pjesë drejtuesi i njësisë, një lektor i fushës dhe lektori i lëndës të cilët kryejnë rivlerësimin e tezës dhe brenda tri ditëve e njoftojnë me shkrim studentin për rezultatin. Ky vendim është përfundimtar.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 3 Rregullore e programit të studimit Msc TR neni 20].</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit t tyre. Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë transparente.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” zhvillohet mbi bazën e një kurrikule të hartuar nga një staf i kualifikuar dhe i trajnuar në fushën e turizmit dhe në veçanti specialist të Teologjisë. Në këtë kuptim ajo merr në konsideratë standardet europiane që kërkojnë për hartimin e një kurrikule duke garantuar thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve në lëmin e turizmit religjioz.</p> <p><i>[Ref. RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Shtojca nr. 2.2 Plani Mësimor TR].</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Referuar kurrikulës së programit të studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” konstatohet që ajo përmban lëndë/module të tilla si “Turizmi Elektronik”, “Metodologjia e Hulumtimit” etj, të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. Po ashtu, në planin mësimor të programit ka lëndë si “Trashëgimia Religjioze dhe Kulturore e Shqipërisë I dhe II”, “Arkitektura dhe Arti”, “Zhvillimi Turistik Lokal” etj, të cilat përcjellin tek studentët edhe vlera humanizmi, sociale, komunikimi e ndërveprimi.</p> <p><i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 2.2 Plani Mësimor TR].</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset</p>	<p>Qysh në fillim të zhvillimit të programit të lëndës, studenti njihet me përmbajtjen e syllabusit të hartuar nga titullari i lëndës. Në realizim të programit mësimor, për çdo lëndë të veçantë, analizohen e shqyrtohen</p>





<p>e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në testet dhe vlersimet përkatëse, në diskutimet për to si dhe duke tërhequr vlerësimet e të diplomuarve e të punësuarve në këtë PS. Mbi këtë bazë bëhen edhe plotësimet e përmirësimet në syllabuse në masën deri 20%. Për programin e studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”, për shkak të kohës së shkurtër nga fillimi (viti 2018-2019), ndryshimet në planin mësimor dhe në syllabuse janë të pakta.</p> <p><i>[Ref. RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Shtojca nr. 25.2 Raporte të Takimeve me Stafin].</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri shërben shqyrtimi i praktikave që zhvillohen në terren në objekte kulti dhe muzeume. <i>GVJ konstatoi që nuk ka laborator me program të dedikuar për zhvillimin e kompetencave lëndorë që do të ishte shumë i dobishëm për zhvillimin e mësimin në lëndën Turizmi Elektronik. RVB, Shënimet nga vizita në institucion</i></p> <p>Duke konsultuar planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton që zhvillimi i detyrave apo projekteve kërkon punën në grup, e cila mbështetet nga personeli akademik i ngarkuar me zhvillimin e këtij programi si dhe realizohet nga studentët e tij. Në takimin me studentët ata u shprehën të arrirë me funksionimin e punës në grup si dhe evidentuan kontributin e pedagogëve në realizimin me sukses të saj.</p> <p><i>[Ref. RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Shtojca nr. 30.1 Aktivitete në kuadër të programit MSH në TR 2021-2023].</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në plotësim të këtij kriteri, GVJ konsultoi “linqet e vëna në dispozicion nga RVB dhe gjeti plot aktivitete të personelit akademik që dëshmonin veprimtari jashtë strukturës së programit të studimit. Aktivitete të tjera të rëndësishme ishin edhe aktivitetet e zhvilluara nga “Forumi i Turizmit Religjioz” dhe “Java e Turizmit Religjioz” ku personeli akademik efektiv dhe i ftuar ka referuar mbi zhvillimet më të reja të shkencës dhe teknologjisë.</p> <p><i>[Ref. RVB, Shënimet nga vizita në institucion; Shtojca nr. 30.2 dhe 30.3].</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Në të gjitha mjediset e realizimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” krijohet klimë e përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe studimeve kërkimore duke mbledhur, administruar, vlerësuar, analizuar e vizualizuar të dhëna që shërbejnë në krijim shtigjeve turistike të religjionit dhe pelegrinazhit duke ndihmuar në krijimin e produkteve turistike të kësaj linje. Ndërtimi i këtyre modeleve turistike, të tematizuar sipas problematikës, të realizuar nga studentët çon tek zbulime të ligjësiive me interes për përdorimin në tregun e punës.</p>

	<i>[Ref. RVB, Shënime nga vizita në institucion, Shtojca nr. 30.1 Aktivitete në kuadër të programit MSH në TR 2021-2023].</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka ngritur strukturat përkatëse për garantimin e rritjes së aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët, duke i motivuar ato dhe në kërkimin shkencor dhe të aplikuar, por duhet të investojë në pajisjen e laboratorëve me programeve kompjuterike në funksion të përdorimit të teknologjisë në lëmin e turizmit me qëllim aftësimin praktik të studentëve para daljes në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse. Programi i studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” mbyllet me mbrojtjen e tezës së diplomimit para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti. Studentët shkruajnë tezën e tyre të diplomës nëse i kanë kaluar me sukses të gjitha lëndët, bazuar në nenin 3 (tri) të rregullores së diplomimit. Studentët njihen herët me këtë detyrim dhe hapat që duhen përmbushur. <i>[Ref. Shtojca nr. 13.2 Rregullorja e Diplomimit për Msc TR].</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”, mikëpritje dhe aktivitete çlodhëse asiston dhe ndihmon studentët duke iu dhënë atyre informacion, të dhëna, udhëzime për materialet në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. Për këtë, Departamenti, ka vënë në dispozicion të studentëve Rregulloren për Tezën e Diplomimit të Programit të Studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”. <i>[Ref. Shtojca nr. 13.3 Rregulloren për Tezën e Diplomimit Msc TR].</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/	Bazuar në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” dhe në Rregulloren e Diplomimit përmbyllja e detyrimeve në këtë cikël studimi kryhet vetëm me mbrojtje të tezës së diplomimit dhe jo me testim njohurish. <i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 13.2 Rregullorja e Diplomimit për Msc TR].</i>




<p>modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri GVJ konsaton se shërben rregullorja për Tezën e Diplomimit në Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”. Në të pasqyrohen</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Procedurat e paraqitjes dhe përgatitjes së temës B. Udhëzimet e përgjithëshme për përgatitjen C. Shtojca I (formular i propozimit) D. Shtojca II e III (Stuktura e punimit) E. Shtojca IV (Tabela e vlerësimit) <p>Personeli akademik udhëzon dhe orienton studentët rreth temave dhe njohurive që do të testohen në provimin final.</p> <p>Për studimet që përbullen me temë diplome është përgjegjësi e Udhëheqësit të diplomës t'i ofrojë studentit mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme për të arritur standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit.</p> <p>Udhëheqësi ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës, të bëjë kritikën e duhura për punimin e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës.</p> <p><i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 13.2 Rregullorja e Diplomimit për Msc TR; Shtojca nr. 13.2 Rregullorja e Diplomimit për Msc TR, Shtojca nr. 26.8, nr. 13.8].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, konstatojmë se pedagogu udhëheqës i studentit që provën finale e ka me temë diplome asiston dhe udhëzon atë gjatë gjithë procesit të kërkimit. Në varësi të temës dhe fushës së studimit institucioni krijon kushte të përshtatshme për mbështetjen e studentit si brenda institucionit, në KU “LOGOS”, si edhe jashtë tij në institucionet partnere.</p> <p><i>[Ref. RVB; Vizita në institucion].</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në plotësimin e këtij kriteri GVJ shqyrtoi Shtojcën IV të rregullores së diplomimit në të cilën paraqitet skema e vlerësimit. Sipas kësaj skeme çdo anëtar i komisionit bënë vlerësimin me notë dhe mesatarja e shumës së vlerësimeve të marra përcakton pikët përfundimtare të konvertuara në notë.</p> <p><i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 13.2 Rregullorja e Diplomimit për Msc TR].</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me</p>	<p>Diploma, shoqëruar me suplementin është hapi i fundit. Studenti pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, si dhe listën e notave të lëshuara</p>




<p>diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>nga KU "LOGOS" dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në Republikën e Shqipërisë, pastaj vijojnë hapat e tjerë drejt licensimit deri në punësim, hapa për të cilët insitucioni vazhdon të jetë i informuar.</p> <p>Modeli i diplomës është ai që është hartuar në përputhje me aktet rregulluese, i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe i regjistruar në QSHA.</p> <p>Në përfundim të studimeve, sipas kërkesë së studentit, studentit i vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 13.2 Rregullorja e Diplomimit për Msc TR; SHtojca Nr. 14.1 Diploma Model Msc Turizëm Religjioz; Shtojca nr.14.2 Supplement Msc Turizëm].</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Në takimet me sekretarinë mësimore u konstatua se në miniarkivën e Sekretarisë Mësimore mbahen, deri në përfundim të studimeve të studentit dhe pajisjes me diplomën përkatës, dokumentacioni në vijim: dosja personale e studentit, regjistrat mësimorë, fletet e vlerësimit të firmosura nga Dekani i Fakultetit dhe përfaqësuesi i autorizuar i sekretarisë mësimore, regjistri i lëshimit të diplomave, regjistrat e studentëve me të gjitha të dhënat dhe rezultatet sipas përcaktimeve të Minsitrisë përgjegjëse për arsim, kalendari akademik, planet mësimore (origjinale të dyta), kopje e diplomës së lëshuar, dorëzuar nga studenti. Ky dokumentacion aksesohet sa herë lind nevoja ose kërkohet informacion në lidhje me studentët. Tezat e provimit të studentit ruhen për një periudhë 3 mujore sipas rregullores së protokoll arkivës dhe të sekretarisë mësimore.</p> <p><i>[Ref. RVB; Shtojca nr. 1.5 Rregullore e Arkiv-Protokollit neni 15].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit si dhe e pajis studentin me dokumentacionin përkatës pas përfundimit të studimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive praktike dhe profesionale, Departamenti garanton mjedise brenda institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës profesionale.</p> <p>Po ashtu, në marrëveshjet që Departamenti ka nënshkruar me Institucione të tjera për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, intitucionet pritëse kanë marrë përsipër dhe i kanë ofruar studentëve të gjitha mjediset e nevojshme të përshtatshme për realizimin e praktikave profesionale.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 22.2 Marrëveshje me Institucione dhe Organizata bashkëpunuese].</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitave në KU “LOGOS”, GVJ thekson se kapacitetet infrastrukturore të institucionit janë të përshtatshme dhe të posacme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Përveç kapaciteteve të saj, KU “LOGOS” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të tjera për të plotësuar të gjitha nevojat infrastrukturore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p> <p><i>[Ref. RVB].</i></p>			
<p>Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Gjatë periudhës së studimeve, studentët kanë detyrim edhe kryerjen e praktikës profesionale. Kjo periudhë praktike ekuivalentohet në kredite dymbëdhjetë të konvertuara në 300 orë ngarkesë totale dhe gjithshka dokumentohet. Në përfundim të periudhës së praktikës, studentët duhet të dorëzojnë raportin e praktikës. Pjesë e këtij raporti është edhe mendimin i trajnerëve dhe vlerësimi nga mbikqyrësi i praktikës në organizatën/institucionin pritës.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 2.4 Rregullore e praktikës Msc TR; Shtojca nr. 13.6 Praktikë dokumenta të plotësuar].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni një procedurë të qartë për zbatimin e njohurive nëpërmjet praktikës si dhe ka marrë të gjitha masat për lidhjen me industrinë e turizmit, në funksion të marrjes së njohurive praktike si dhe punësimit të studentëve pas diplomimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**


Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar procedurës së rekrutimit, si dhe asaj të konsultuar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, i angazhuar në zbatimin e programit të studimit, i plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Në programin e studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” japin mësim lektorë nga disa departamente, specifikuat nga tre lektorë me kohë të plotë nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës dhe Departamenti i Menaxhimit, si dhe një lektor nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë. Krahas këtyre janë dhe nëntë lektorë me kohë të pjesshme nga universitete vendase dhe ndërkombëtare.</p> <p>Bazuar në CV e stafit akademik rezulton se ata zotërojnë kualifikimin e duhur akademik për drejtimin e programit, duke mbuluar sipas fushës lëndët dhe modulet mësimore të programit.</p> <p>Ndërkohë ngarkesa vjetore mësimore e personelit akademik miratohet me vendim të Senatit Akademik, sipas kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabelat nr. 6.1 dhe 6.2 të tabelave mbështetëse; Shtojca nr. 7.6.1: CV- të e Stafit Akademik, Shtojca: Tabelat nr.12.1 dhe 12.2 të tabelave mbështetëse].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, evidencave dhe vizitës në institucion, del në pah se KU “Logos” zbaton kërkesat ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Sipas të dhënave me anë të evidencave vihet re një raport i lartë i stafit me kohë të pjesshme në krahasim me stafin me kohë të plotë, ku shumica vijnë nga jashtë departamentit. Gjatë vizitës në institucion u argumentua specifika e vetë programit, i cili vjen si një program i përbërë nga disa fusha akademike. Megjithatë stafi akademik i moduleve dhe lëndëve garanton qëndrueshmërinë e programit.</p> <p><i>GVJ rekomandon balancimin e mbulimit të ngarkesës mësimore me staf efektiv me kohë të plotë.</i></p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 7.4.1: Kontrata PAE model; Shtojca nr. 7.4.2: Kontrata PAK model].</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Sipas vlerësimit në RVB dhe verifikimeve të kryera gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton praktikën e ndjekjes së procedurave të rekrutimit të personelit akademik, në përputhje me kriteret e bëra publike dhe sipas rregullores institucionale, sipas Kodit të Punës, Ligji nr. 80/2015, aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p>Procedurat e rekrutimit ishin dokumentuar dhe plotësuar në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik në KU Logos.</p> <p>Në evidencat e vëna në dispozicion vihet re se IAL ka rekrutuar edhe anëtarë të personelit akademik, të cilët kanë përfunduar studimet universitare jashtë vendit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 7.6.1: CV-të e Stafit Akademik; Shtojca nr. 7.5: Paketa e rekrutimit Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës 2022-2023].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë se sipas kurrikulës, ka disa lëndë që kanë laboratorë ose përdorim të aplikacioneve të veçanta në industrinë e turizmit, si p.sh. “Turizmi Elektronik”. Për këtë IAL ka punësuar personel të specializuar për këtë fushë, ku garantohej realizimi i orëve laboratorike dhe mirëmbajtja e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.7.6.1: CV-të e Stafit Akademik; Shtojca: Tabelat nr.6.1 dhe 6.2 të tabelave mbështetëse].</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>RVJ referuar RVB dhe vizitës në institucion konstaton se IAL ruan informacionin në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në dy njësi të ndryshme.</p> <p>Të dhënat në lidhje me stafin akademik në njësinë e parë mblidhen dhe ruhen pranë njësisë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit (në këtë rast Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës në kampusin nr. 2 në Shën Vlash). Në njësinë e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik, ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësimor, mblidhen dhe administrohen nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila administron dosjet e plota për çdo anëtar të personelit, e cila çdo vit akademik mbledh dhe përditëson të dhënat e personelit akademik, të rekrutuar sipas nevojave të propozuara nga departamenti.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.7.3: Formati i dosjes personale të stafit; Shtojca nr. 7.6.1: CV-të e Stafit Akademik].</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti Teologjisë dhe Kulturës ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendi në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale. Departamenti gjithashtu ka vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të</p>



39


<p>mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale si dhe punimin e diplomës. IAL ofron gjithashtu një dokument për studentët, që duhet të plotësohet dhe të jetë pjesë e dosjes së tyre. Megjithatë mungon një evidencë me listën e plotë të marrëveshjeve, pavarësisht se ato janë përmendur në raport.</p> <p><i>GVJ rekomandon hartimin e një liste të plotë, si dhe marrëveshjet specifike me secilin institucion.</i></p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 2.4: Rregullore e Praktikës MSC TR, shtojca nr. 30.1: Aktivitetet në kuadër të programit MsC në Turizëm Religjioz 2021-2023].</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në Rregulloren e Praktikës, çdo student bashkëpunon me mbikëqyrësin e tij/saj për procesin e praktikës. Me anë të marrëveshjeve të nënshkruara midis institucioneve, mbikëqyrësi ka të drejtë të ketë gjithashtu kontakt të drejtpërdrejtë me institucionin, që studenti ka zgjedhur. Sipas rregullores, po ashtu në rast të një problemi, komisioni i praktikës e diskuton këtë çështje me mbikëqyrësin e praktikës dhe me studentin për ta zgjidhur problemin sipas rastit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 2.4: Rregullore e Praktikës MSC TR].</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ bazuar në raportin e GVB dhe vizitën në institucion ka konstatuar se kriteret e standardit nr. IV.1 janë përmbushur plotësisht.</i> • <i>Kështu bazuar në CV e stafit akademik rezultojnë se ata zotërojnë kualifikimin e duhur akademik për drejtimin e programit, duke mbuluar sipas fushës lëndët dhe modulet mësimore të programit.</i> • <i>Megjithatë vihet re një përqindje e lartë e stafit me kohë të pjesshme në raport me stafin me kohë të plotë. Për këtë GVJ rekomandon balancimin e mbulimit të ngarkesës mësimore me staf efektiv me kohë të plotë.</i> • <i>Institucioni po ashtu ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit.</i> • <i>RVJ gjithashtu konstaton se IAL ruan informacionin në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në dy njësi të ndryshme.</i> • <i>GVJ konstaton se Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendi në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale. Megjithatë mungon një evidencë me listën e plotë të marrëveshjeve, pavarësisht se ato janë përmendur në raport. GVJ rekomandon hartimin e një liste të plotë, si dhe marrëveshjet specifike me secilin institucion.</i>





	<ul style="list-style-type: none"> GVJ konstaton gjithashtu se bazuar në Rregulloren e Praktikës, çdo student bashkëpunon me mbikëqyrësin e tij/saj për procesin e praktikës. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se Kolegji Universitar “LOGOS” funksionon me dy kampuse. Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës zhvillon veprimtarinë mësimore Bachelor në godinën e kampusit nr. 2 në Shën Vlash, Durrës, i cili ka një sipërfaqe prej 2.117 m². Ndërsa programi i studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” kryhet në kampusin qendror të Kolegjit Universitar “LOGOS”, me vendndodhje në Tiranë në adresën Rr. “Dritan Hoxha”, Pallatet Komfort, 1001. Mjediset në shërbim të IAL-së ofrojnë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabela nr.16 e tabelave mbështetëse].</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur në evidenca (Tabela 16), GVJ konstatoi se ambientet mësimore në KU “Logos” ishin të pajisura me kompjutera dhe/ose laptop, video-projektorë, lidhje interneti wireless dhe kushte të tjera të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor. Linja e internetit në të gjithë kampusin jep mundësinë e ndërveprimit me metodologjitë e teknologjive moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies me metoda bashkëkohore.</p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabela nr. 16 e tabelave mbështetëse].</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” ka në dispozicion dy laboratorë informatike, që mund të aksesohen në çdo moment gjatë gjithë javës. Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët, GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi, që shfrytëzohen edhe për workshope e aktivitete të tjera laboratorike.</p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabela nr. 16 e tabelave mbështetëse].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të</p>	<p>GVJ konstatoi se në mjediset e Kolegjit Universitar “LOGOS” janë ngritur dy laboratorë kompjuterikë, të cilët përmbajnë 40 kompjutere</p>




41


<p>pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>desktopë, të pajisur me programe të ndryshme të vlefshme për programin e studimit. IAL ka siguruar platformat e komunikimit elektronik si: NeoLMS, Ms Teams dhe EduPage.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 16.3: Guida për mësimdhënësit Neo LMS; Shtojca nr.16.4: Manuali-i-Office-365-Teams-Pedagogët; Shtojca nr. 16.5: Manuali-i Office-365-Teams-Studentët; Shtojca nr. 16.6: Manual-Edupage-Pedagogët; Shtojca nr. 16.7: Manual-Edupage-Studentët].</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Bazuar në të dhënat mbi evidenca, RVB dhe vizitat në institucion, IAL garanton kapacitete të mjaftueshme për formimin praktik të studentëve në programet e fushës së turizmit religjioz.</p> <p>Institucioni ka gjithashtu marrëveshje me agjenci turistike, të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe praktikave profesionale. Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës dhe Forumi i Turizmit Religjioz</p> <p>Kanë organizuar “Javën e Turizmit Religjioz”, ku janë prezantuar projekte të studentëve, pjesë e këtij programi studimi.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 30.1: Aktivitetet në kuadër të programit MsC në Turizëm Religjioz 2021-2023; Shtojca nr. 30.3: Programi - Java e Turizmit Religjioz (shkurt 2023)].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në raportin e GVB dhe vizitën në institucion ka konstatuar se kriteret e standardit nr. IV.2 janë përmbushur plotësisht.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kolegji Universitar “LOGOS” funksionon me dy kampuse.</i> • <i>Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës zhvillon veprimtarinë mësimore Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz” në kampusin qendror të Kolegjit Universitar “LOGOS”.</i> • <i>Ambientet mësimore në IAL kishin dy laboratorë informatike dhe auditorët ishin të pajisura me kompjuterë, video-projektorë, lidhje interneti wireless dhe kushte të tjera të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor.</i> • <i>Bazuar në të dhënat mbi evidenca, RVB dhe vizitat në institucion, IAL garanton kapacitete të mjaftueshme për formimin praktik të studentëve në programet e fushës së turizmit religjioz.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


Standardi IV.3


Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------




<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar konstaton se literatura e nevojshme për lëndët e zhvilluara është në dispozicion të studentëve në mënyrë fizike ose dixhitale në platformën Neo LMS. Kur lektori përdor literaturë në gjuhë të huaj, IAL ka vënë në dispozicion dy përkthyes për përkthimin e literaturës së lëndëve të programeve të studimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 27.5: Statistika të Bibliotekës, Shtojca nr.16.8: Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve].</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ gjatë shqyrtimit të raportit dhe vizitës në IAL vëren se ka një përpjekje për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. Departamenti ka filluar të botojë gjithashtu dhe materiale të reja mbi Turizmin Religjioz në përgjithësi dhe Turizmin Religjioz në Shqipëri. Megjithatë nevojitet një punë më e madhe në këtë fushë për të nxjerrë në pah monumentet kulturore të të gjitha besimeve fetare, pjesë e trashëgimisë sonë kombëtare.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 21.3: Botime të Departamentit në funksion të programit; Shtojca nr. 2.3: Program Mësimor - Master TR].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas verifikimeve të dokumentacionit kryer nga GVJ, institucioni raporton se ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur, e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka elektronike. Kjo sallë është në dispozicion të studentëve të këtij programi.</p> <p>Studentët kanë mundësi të anëtarësohen në bibliotekë dhe të huazojnë literaturën e nevojshme jashtë mjediseve fizike të dy bibliotekave në të dy kampuset. Bibliotekat japin në shërbim çdo ditë të javës nga ora 08.00 deri në 20.00.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 27.3: Modeli i kartës së bibliotekës].</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga IAL referohet se në bibliotekat e institucionit gjatë dy viteve të funksionimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”, biblioteka “Logos” është pasuruar me 92 libra (86 shqip, 5 anglisht, 1 greqisht), ndër të cilët 52 tituj (48 shqip, 3 anglisht, 1 greqisht). Ndërsa biblioteka “Ngjallja” në kampusin e Shën Vlashit është e pajisur me 592 tituj, të ndarë sipas njësive bibliotekare, që mbulojnë disa nga lëndët bazë të kurrikulës së programit të studimit, si dhe një sasi të konsiderueshme literaturë shoqëruese, të tilla si kurrikula, si dhe për kërkimin shkencor.</p> <p>GVJ vëren gjithashtu se gjatë pesë viteve të funksionimit të Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, biblioteka është pasuruar me 814 libra (235 shqip, 405 greqisht, 174 anglisht), ndër të cilët 700 tituj (159 shqip, 374 greqisht, 167 anglisht), me 10 e-books në gjuhën shqipe,</p>



43


	<p>e-revistë akademike 5 numra, e-revistë studentore 5 numra dhe periodikë elektronikë.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 27.5: Statistika të Bibliotekës; Shtojca nr. 27.6: Shtimi i titujve në lidhje me programin].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar kushte të përshtatshme për akses pa pagesë në bibliotekën online, ku mund të aksesojnë libra, revista dhe enciklopedi elektronike, që kanë lidhje me studimet e tyre.</p> <p>Studentët për përdorimin elektronik të bibliotekës trajnohen në një ëorkshop dhe marrin udhëzime se si të përdorin platformën online dhe aksesin në këto baza të dhënash. Ata mund të përdorin gjithashtu katalogun elektronik të bibliotekës, të pajisen me adresa elektronike aksesit falas në shërbim të programit, të kenë akses në bazën e të dhënave Jstor, Ebsco, si dhe bibliotekën dixhitale të Universitetit "Aristoteli" të Selanikut.</p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabela nr.17 e tabelave mbështetëse; Shtojca nr. 27.4: Trajnime për bibliotekën].</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në sallat e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim aksesit në internet nëpërmjet rrjetit wireless, që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të KU "LOGOS". Biblioteka "Logos" ishte e pajisur me kompjuterë, që përmbajnë platformat e kërkimit falas nëpërmjet e-mailit në Jstor dhe Ebsco. Studentët i përdorin gjithashtu kompjuterët e bibliotekës edhe për të realizuar detyrimet e tyre në lëndë të ndryshme. Biblioteka është e pajisur me fotokopje dhe printera, të cilat mund të përdoren nga studentët.</p> <p>Fondi i Bibliotekës paraqitet në bazën elektronike të të dhënave përmes regjistrimeve në programin e përbashkët të katalogimit elektronik PLEIADES, bazuar në standardin MARC 21.</p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabela nr. 16 e tabelave mbështetëse; Shtojca: Tabela nr. 17 e tabelave mbështetëse; Katalogu: http://lib-orthodoxalbania.org].</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Salla e Bibliotekës së KU "Logos" konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e saj koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në këtë program studimi. Nga ana e GVJ fasha e orareve të bibliotekës (nga e hëna në të premte nga ora 08:00 deri në 20:00) konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor për atë numër studentësh, që ndjekin këtë program studimi. Kjo u konfirmua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Sipas RVB, sipërfaqja e bibliotekës "Logos" rezulton të jetë 180 m², ndërsa biblioteka "Ngjallja" është 118m², të cilat i plotësojnë kërkesat e bibliotekave bashkëkohore. Kjo e fundit frekuentohet edhe në fundjavë</p>




	nga ora 14:00 deri në 20:00, orar specifik ky, i cili shfaqet në hyrje të bibliotekës.			
	<i>[Ref. Shtojca: Tabela nr.16 e tabelave mbështetëse].</i>			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se Fondi i Bibliotekës pasurohet vazhdimisht me materiale në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, nëpërmjet blerjeve, shkëmbimeve, dhuratave dhe abonimeve. IAL ka siguruar gjithashtu edhe literaturë falas nëpërmjet bashkëpunimit me shtëpi të ndryshme botuese me tituj dhe literaturë në lidhje me turizmin dhe religjionin. Biblioteka ka gjithashtu rregulloren e saj dhe një plan për rritjen cilësore dhe sasiore. Ndërsa departamentet po ashtu mund të bëjnë kërkesë për blerjen e titujve dhe librave të rinj në lidhje me programin e studimit para fillimit të vitit akademik. Fondi i bibliotekës është i parashikuar në buxhet dhe realizohet me bazë vjetore.			
	<i>[Ref. Shtojca nr.5.2: Plani Strategjik i Departamentit 2022-2025; Shtojca nr. 27.1: Rregullore e Bibliotekës; Shtojca nr. 27.2: Strategjia e bibliotekës 2019-2023].</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në raportin e GVB dhe vizitën në institucion ka konstatuar se kriteret e standardit nr. IV.3 janë përmbushur plotësisht. <ul style="list-style-type: none"> • Kështu GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar konstaton se literatura e nevojshme për lëndët e zhvilluara është në dispozicion të studentëve në mënyrë fizike ose dixhitale. • Departamenti boton gjithashtu dhe materiale të reja në lidhje me Turizmin Religjioz. Megjithatë nevojitet një punë më e madhe në këtë fushë për të nxjerrë në pah monumentet kulturore të të gjitha besimeve fetare, pjesë e trashëgimisë sonë kombëtare. • Sipas verifikimeve të dokumentacionit kryera nga GVJ, institucioni raporton se ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur, e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka elektronike e ndodhur në dy kampuse. • Fondi i Bibliotekës paraqitet në bazën elektronike të të dhënave përmes regjistrimeve në programin e përbashkët të katalogimit elektronik PLEIADES, bazuar në standardin MARC 21, si dhe pasurohet vazhdimisht me materiale në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, nëpërmjet blerjeve, shkëmbimeve, dhuratave dhe abonimeve. • Biblioteka ka rregulloren e saj dhe një plan për rritjen cilësore dhe sasiore. Departamentet po ashtu mund të bëjnë kërkesë për blerjen e titujve dhe librave të rinj në lidhje me programin e studimit para fillimit të vitit akademik. Fondi i bibliotekës është i parashikuar në buxhet dhe realizohet me bazë vjetore. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


45
Gjia


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u vu në dijeni nëpërmjet evidencave dhe vizitës në IAL, se KU “Logos” ka në përdorim dhe shfrytëzon një sistem të automatizuar të menaxhimit të informacioneve në lidhje me ecurinë e studentëve.</p> <p>Përgjegjësia për regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e statistikave vjetore përcaktohen në rregulloren e universitetit. Nëpërmjet zyrës së IT, sigurohet baza e të dhënave dhe sistemet elektronike për mbledhjen, përpunimin dhe transmetimin e evidencave, që lidhen me veprimtarinë akademike, që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Në bazë të udhëzimeve dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015, neni 101, IAL mban regjistrat me të dhëna specifike për regjistrimin e studentëve, numrat e regjistrimit etj. në Sekretarinë Mësimore. IAL mban gjithashtu të dhënat e plota elektronike për studentët aktualë dhe të diplomuar në Sekretarinë Mësimore, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Ata ruhen po ashtu edhe fizikisht në dosjet personale nga sekretaria mësimore.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 19.1: Regjistri i Regjistrimit të Studentëve; Shtojca nr. 19.2: Databazë e Studentëve; Shtojca nr. 1.6].</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sipas RVB, dhe vizitës në institucion, Zyra e Burimeve Njerëzore e IAL-së administron dhe mbledh informacionin, dokumentacionin dhe veprimtarinë e personelit akademik, personelit mbështetës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në zbatimin e programit: diplomat, arrijtet akademike, CV-të dhe të gjithë informacionin e nevojshëm.</p> <p>IAL i ka ngarkuar gjithashtu zyrës së Administratorit të Fakultetit detyrën e mbledhjes dhe raportimit të statistikave. Çdo njësi, në përputhje me natyrën e punës, angazhohet në përpunimin e statistikave të ndryshme nga viti në vit dhe ato i përcillen Zyrës së Administratorit të Fakultetit, i cila përgatit raportet përkatëse, që do të kalojnë në MAS. Po ashtu kjo zyrë vë në dispozicion të njërive brenda IAL-së të gjitha statistikatat për kryerjen e studimeve, apo kërkimeve të nevojshme për miradministrimin e institucionit apo kurrikulave.</p> <p>Ndërsa zyra e IT-së në institucion kujdeset për dixhitalizimin e të dhënave dhe ruajtjen e dokumentacionit në formë elektronike. Kjo strukturë ka krijuar një bazë të dhënash elektronike për ruajtjen e dokumentacionit të administratës së IAL-së në formë elektronike.</p>


	<p><i>[Ref. Shtojca nr. 7.3: Formati i dosjes personale të stafit; Shtojca nr. 7.4.1: Kontrata PAE model; Shtojca nr. 7.4.2: Kontrata PAK model; Shtojca nr. 7.4.3: Kontrata tip staf administrativ ndihmës akademik].</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe siç u konfirmua edhe gjatë vizitës në IAL, studentët mund të aksesojnë online rezultatet për lëndët që ndjekin, si dhe të kontrollojnë informacione të tjera rreth tyre, nëpërmjet sistemit EduPage, i cili ofron akses të dedikuar në informacion dhe dokumente për të gjithë studentët dhe gjithashtu personelin e programit të studimit.</p> <p>Ndërfaqja në internet, mund të aksesohet nga çdo përdorues, duke vërtetuar me një kombinim Emër/Fjalëkalim në: kulos.edupage.org</p> <p>Aplikacioni Outlook i lejon studentët të përdorin një adresë zyrtare e-maili të siguruar nga IAL, e cila është e rëndësishme për të siguruar autenticitetin e komunikimit brenda institucionit dhe jashtë tij. E-maillet zyrtare janë të disponueshme për personelin dhe studentët.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 16.4: Manuali-i-Office-365-Teams-Pedagogët; Shtojca nr. 16.5: Manuali-i Office-365-Teams-Studentët; Shtojca nr. 16.6: Manual-Edupage-Pedagogët; Shtojca nr. 16.7: Manual-Edupage-Studentët].</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sipas të dhënave të referuara në RVB, sistemi Microsoft Teams mundëson ndërveprimin brenda mes aktorëve të institucionit, duke i dhënë studentëve dhe personelit mundësinë e një mjedisi elektronik aktiv, për ndarjen e materialeve mësimore për projekte dhe aktivitete të përditshme universitare.</p> <p>Aksesi në këtë platformë sigurohet nga web ose përmes aplikacioneve të dedikuara për Windows, MacOS, Linux, Android dhe hyrja bëhet nëpërmjet kombinimit Emër/Fjalëkalim.</p> <p>Zbatimi dhe mirëmbajtja e platformës së sistemit dixhital bëhet nëpërmjet zyrës së IT-së së IAL-së, ku arkivohen leksionet, detyrat, provimet dhe çdo komunikim tjetër ndërmjet personelit akademik dhe studentëve të KU “LOGOS”.</p> <p>RVJ nëpërmjet RVB-së dhe vizitës në IAL konstatoi se Departamenti i Teologjisë përdor gjithashtu platformën NeLMS për të dërguar mesazhe të sigurta, njoftime mësimore, njoftime administrative dhe mesazhe personale midis lektorëve dhe studentëve.</p> <p>IAL ka krijuar gjithashtu një grup Teams për studentët, të quajtur “Asambleja Studentore” ku studentët mund të ndërveprojnë me Mentorin Akademik dhe sekretarinë e Departamentit për të diskutuar ecurinë e studimeve të tyre. Sekretaria e Departamentit përdor gjithashtu dhe platformat whatsapp dhe viber për të komunikuar me studentët.</p>



47



	[Ref. Shtojca nr. 31.6: Asambleja studentore; Shtojca nr. 25.1: Raporte të takimeve me studentët; Shtojca nr. 31.3: Komunikime në grup nëpërmjet Ëhatsap].			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Platformat dixhitale Microsoft Teams dhe NeoLMS garantojnë në kohë reale monitorim të veprimtarisë akademike dhe administrative, duke lehtësuar punën në institucion e duke garantuar korrektësi, mbi bazën e të gjitha udhëzimeve e procedurave që dalin nga senati dhe rektorati. Ky sistem jep mundësi, si për studentët, edhe për stafin akademik, të monitorojnë në kohë reale pjesëmarrjen në mësim, notën, të dhënat e studentit, lëndët, etj. Ndërsa EduPage përdoret për qëllime administrative për regjistrimin e notave dhe ofrimin e informacionit të nevojshëm zyrtar studentëve dhe lektorëve. [Ref. Shtojca nr. 16.8: Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve].			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	KU "LOGOS" bën publike në faqen e tij zyrtare në internet www.kulogos.edu.al , të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera, në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, të dhëna të cilat përditësohen nga zyra e IT-së. Po ashtu edhe informacionet në lidhje me departamentin gjenden në linkun e mëposhtëm në shqip dhe anglisht: https://theolkulogosalb.wordpress.com Informacioni për Departamentin pasqyrohet edhe në mediat sociale të Kolegjit Universitar "LOGOS" Facebook dhe Instagram, si dhe në mediat sociale të Departamentit (Facebook, Instagram, LinkedIn, Twitter, Youtube, Reddit, Telegram, Viber, TikTok, Spotify). [Ref. Shtojca nr. 31.2: Informim nëpërmjet mediave sociale; Shtojca nr.31.1: Paraqitje e faqes së internetit KU LOGOS].			
Konkluzione	Nëpërmjet platformave dixhitale Microsoft Teams, NeoLMS dhe EduPage, që përdoren në KU "Logos", administrohet i gjithë informacioni, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Në faqen zyrtare të universitetit në internet, www.kulogos.edu.al jepen të gjitha informacionet mbi programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera, të cilat janë të publikuara në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5




Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës e sipas RVB, institucioni harton raport vjetor financiar të kostove të njësisë bazë e të detajuara sipas zërave që mbështesin, nga pikëpamja buxhetore, mbarëvajtjen e programeve të studimit me shpenzimet dhe të ardhurat përkatëse.</p> <p>IAL gëzon statusin e institucionit të arsimit të lartë jofitimprurës. Sipas statutit, ai mbështetet në kapitalin e themeluesit e pasuri të tjera të vëna në dispozicion prej tij, donacione të ndryshme, të ardhura të ndryshme të krijuara e burime të tjera të ligjshme financiare.</p> <p><i>Pavarësisht referimit në RVB si një institucion modest, GVJ sugjeron që është e nevojshme gjithashtu përgatitja e një raporti financiar në nivel të njësisë bazë dhe programit.</i></p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabela nr. 18 e tabelave mbështetëse].</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi të ardhurat dhe financimet e institucionit, konstatohen ndarjet sipas zërave përkatës, si grantet për kërkim dhe kontratat, konsulentat e shërbimet, tarifat për dhe gjatë shkollimit, donacionet etj. I detajuar në zëra e shifra përkatëse është edhe projekt-buxheti i hartuar nga njësi bazë në funksion të realizimit të programeve dhe që lidhet me shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve e teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, për bibliotekën e pasurimin e fondit të saj, për aktivitetet studentore, për konferenca, për qëllime promovimi e marketingu, etj.</p> <p>Në përputhje me dispozitat ligjore, neni 52/1/a i ligjit nr. 80/2015, njësitë kryesore dhe njësitë bazë dërgojnë kërkesat e tyre në lidhje me hartimin e buxhetit; në përputhje me nevojat, interesat e institucionit dhe planin strategjik të zhvillimit, të cilat më pas pasqyrohen në zëra konkretë të buxhetit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.6.4: Kërkesa nga departamenti për buxhetin].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Sipas statutit të KU “LOGOS”, Bordi Drejtues i Fondacionit ka si përgjegjësi garantimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit, ndërsa Administratori i Kolegjit është përfaqësuesi ligjor për mirëfunksionimin financiar të tij; në përfundim të çdo viti akademik ai i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit.</p> <p>Në njësinë përgjegjëse, në rolin e administruesit dhe kontrollorit të veprimtarisë financiare të fakultetit është administratori përkatës</p> <p>Në planin strategjik të institucionit, ndër objektivat që lidhen me politikat dhe burimet financiare është theksuar sigurimi i standardeve të</p>



49


	<p>larta të përgjegjësive, integritetit dhe kontrollit financiar, përditësimi i strategjive financiare afatshkurtra dhe afatmesme, duke vlerësuar periodikisht stabilitetin financiar.</p> <p>Institucioni kryen në mënyrë periodike vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së tij financiare. Sipas statutit, institucioni i nënshtrohet edhe auditimit të jashtëm, sipas detyrimit ligjor të përcaktuar nga ministritë përgjegjëse dhe me vendim të Bordit Drejtues të Fondacionit.</p> <p>Raporti i Auditorit të Jashtëm i dorëzohet Bordit Drejtues të Fondacionit dhe shoqëron pasqyrat financiare të vitit financiar përkatës. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Kolegji Universitar “LOGOS” dorëzon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve pasqyrat financiare të shoqëruara me Raportin përkatës të Auditimit të përgatitur nga Eksperti.</p> <p>Po ashtu Zyra e Financës në bashkëpunim me administratorin e Fakultetit dhe administratorin e Institucionit përgatit raporte të progresit financiar, duke krahasuar shpenzimet përkatëse me buxhetin e miratuar dhe informon Bordin e Administrimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 6.2: Detyrimet Tatimore 2021; Shtojca nr. 6.3: Dokument dorëzimi i bilancit 2022; Shtojca nr. 6.1: Rregullore e Zyrës së Financës].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas RVB, fondacioni, pjesë e të cilit është KU “Logos”, harton raportet financiare sipas legjislacionit në fuqi, brenda afateve të përcaktuara dhe me pasqyra të hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>KU “Logos” i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit çdo fund viti akademik raportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar, projekt-buxheti i vitit të ardhshëm akademik si edhe projekt-buxheti afatmesëm</p> <p>Hartimi i buxhetit të Kolegjit Universitar “LOGOS” fillon nga njësia bazë, departamenti, bazuar në nenin 52/1/a, ku merren parasysh nevojat financiare për mbarëvajtjen e programit/eve të studimit për një cikël të plotë studimi.</p> <p>Institucioni kryen një analizë vjetore të shpenzimeve dhe të ardhurave duke përshkruar arsyet e mospërputhshmërisë (nëse ka) dhe i raporton Bordit Drejtues të Fondacionit dhe Bordit të Administrimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.6.4: Kërkesa nga departamenti për buxhetin].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare</p>	<p>Nga vizita në institucion e biseda me drejtuesit e njësisë përgjegjëse e njësisë bazë si dhe bazuar në RVB, rezulton se KU “LOGOS” ka tashmë një përvojë mbi dhjetëvjeçare të funksionimit të tij si IAL jofitimprurëse, ku ka dëshmuar qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit dhe mbështetje të donatorëve për ecurinë normale të programeve. Shpërndarja e burimeve financiare e përdorimi i tyre në bazë të planit financiar është i bazuar në standardet kombëtare të hartimit</p>






<p>institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara, sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL”, në ligjin nr.8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, në ligjin nr. 9224, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe aktet e tjera nënligjore të zbatimit të tyre. Një tregues i rëndësishëm i kujdesit ndaj studentëve është ofrimi i tarifave të ulëta dhe i një numri të konsiderueshëm bursash. [Minutat e vizitës; RVB; Shtojca nr. 20.2: Programi i bursave; Shtojca nr. 6.5: Mbështetje financiare për propozimin e Departamentit].</p>
---	---

<p>Konkluzione</p>	<p><i>KU “LOGOS” gëzon statusin e institucionit të arsimit të lartë jofitimprurës. Projekt-buxheti hartohet në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në programin buxhetor afatmesëm trevjeçar dhe propozimet nga strukturat përkatëse. Pavarësisht referimit në RVB si një institucion modest, GVJ sugjeron që është e nevojshme gjithashtu përgatitja e një raporti financiar në nivel të njësisë bazë dhe programit. Institucioni kryen në mënyrë periodike vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së tij financiare, duke iu nënshtruar edhe auditimit të jashtëm. KU “LOGOS” i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, çdo fund viti akademik, raportin vjetor institucional.</i></p>
---------------------------	---

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---




51


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, KU “LOGOS”, bazuar në Statutin dhe rregulloret e brendshme, zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin akademik të studentëve në programet e ciklit të dytë, nga hyrja në dalje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me këtë program studimi, GVJ konstaton se programi, në të gjithë ecurinë, mbështetet në një sërë aktesh rregullatore institucionale, që u përgjigjen kërkesave të zhvillimit të tij, sipas objektivave përkatës.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.1: Statuti i KU LOGOS; Shtojca nr. 1.2: Rregullore e përgjithshme e KU LOGOS; Shtojca nr. 18.2; Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës në KU LOGOS, Shtojca nr. 20.5: Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me studentët në KU LOGOS; Shtojca nr. 26.3: Vendim Departamenti i Teologjisë për Kriteret e Pranimit të studentëve 2023- 2024; Shtojca nr. 3: Rregullore e Programit të Studimit MSC TR].</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në faqen zyrtare të KU “LOGOS” bëhen publike, për çdo vit akademik, kriteret e pranimit të studentëve edhe për programet e ciklit të dytë, në kushte të barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë. Përveç rregullores bazë të institucionit, është hartuar edhe rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë si dhe rregullorja e posaçme e këtij programi studimi. Në nenet përkatëse të tyre, evidentohen qartazi kriteret e pranimit të studentëve, kompetencat e nevojshme të zotërimit të gjuhës së huaj, vlerësimi i pranimit, njohja e krediteve të nevojshme, procedura e regjistrimit dhe organizimi i procesit mësimor, kushtet e transferimeve nga IAL të tjera, statusi i studentit e shumë çështje të tjera që lidhen me të gjithë procesin e zhvillimit të programit master, të njëjta për të gjithë studentët.</p> <p>Përveç informacionit nga institucioni, të interesuarit për programet e ciklit të dytë mund të marrin të dhëna e të ndjekin procedura regjistrimi dhe aplikimi edhe nëpërmjet portalit U-Albania.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.1.2: Rregullore e përgjithshme e KU LOGOS].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit e biseda më drejtuesit e njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, rezulton se institucioni publikon çdo vit akademik kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për të</p>


<p>kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>studiuar në këtë program. Si procedurë, institucioni i dërgon MAS kuotat përkatëse dhe kriteret, ndërsa i bën ato publike edhe në faqen zyrtare të internetit.</p> <p>Institucioni bashkëpunon me drejtoritë arsimore rajonale dhe, nëpërmjet panairëve të karrierës, që organizon në qytete të ndryshme, prezanton programet e studimit.</p> <p>Bazuar në RVB, vendimet për kriteret e pranimit merren në Senatën Akademik, bazuar në rekomandimet e dhura nga Departamentet e KU "LOGOS" dhe komunikohen nëpërmjet kanaleve zyrtare, si dhe nëpërmjet fushatave promovuese.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 31.1: Paraqitje e faqes së internetit KU LOGOS; Shtojca nr. 31.2: Informim nëpërmjet mediave sociale; Shtojca nr.31.5: Njoftim për takim në lidhje me informimin për ciklin e dytë të studimeve; Shtojca nr.3: Rregullore e Programit të Studimit MSC TR, nenet 7, 8].</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nëpërmjet faqes zyrtare të KU "LOGOS" mund të merret i gjithë informacioni i nevojshëm lidhur me kriteret e procedurat e pranimit të studentëve e të dhëna të tjera, që u referohen programeve të studimit që ofrohen. Njësitë kryesore, por edhe ato bazë që ofrojnë programet, kanë faqet e tyre të internetit, me informacione të nevojshme lidhur me kurrikulat, silabuset e lëndëve, personelin akademik përkatës, etj.</p> <p>Studentët mund të marrin çdo informacion të hollësishëm mbi programin për të cilin janë të interesuar edhe pranë zyrës së pranimit të studentëve apo sekretarisë së departamentit që ofron programin.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 20.5: Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me studentët në KU "Logos"; Shtojca nr.30.5: Promovimi i programeve të Departamentit; Shtojca nr. 18.5: Kalendari i Këshillimit të Karrierës].</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga GJVJ, konstatohet se institucioni, përmes faqes së internetit, panairëve të arsimit dhe karrierës, broshurave e takimeve të drejtpërdrejta, bën të njohur ofertën vjetore të programeve që ofron, bashkë me tarifën e studimit e kriteret e pranimit. Si një institucion jofitimprurës, KU "LOGOS" ndjek politika pranimi që përputhen me infrastrukturën fizike dhe burimet njerëzore që ka në dispozicion.</p> <p>Kriteret: http://www.kulogos.edu.al/al/admissions.html https://theolkulogosalb.wordpress.com/pranimet-2/, https://theolkulogosalb.wordpress.com/master-shkencor-ne-turizem-religjioz-2/</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 18.5: Kalendari i Këshillimit të Karrierës; Shtojca nr.3 0.5: Promovimi i programeve të Departamentit].</i></p>





<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni ndjek politika mbështetëse për të gjithë studentët që janë pjesë e pakicave apo shtresave të marginalizuara.</p> <p>Në rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, ka një nen të posaçëm mbi studentët me aftësi të veçanta, ku garantohej arsimimi i tyre, si pjesë integrale e sistemit arsimor. Institucioni, ka marrë masa për lehtësimin e studentëve të kësaj kategorie edhe nga pikëpamja e infrastrukturës e shërbimeve mbështetëse për ta.</p> <p>https://theolkulogosalb.wordpress.com/cikli-i-dyte-master-i-shkencave/</p> <p>Ndërkohë për programin Master nuk ka raste të studentëve me nevoja të veçanta për këto dy vite akademike.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, parashikohet pranimi i studentëve të huaj, duke plotësuar kërkesat e procedurës së regjistrimit, në përputhje me këtë rregullore.</p> <p>Për studentët e huaj ka dhe një seksion të veçantë në faqen e internetit, ku shpjegohet i gjithë procesi i kriterëve dhe njohjes së dokumenteve të tyre dhe hapat e nevojshëm për qëndrimin e tyre në Shqipëri dhe bashkëpunimin me Ministrinë dhe Institucionin.</p> <p>https://theolkulogos.wordpress.com/second-cycle-master-of-science/</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni harton politika të veçanta që lidhen me ofrim bursash për studentët e programeve të ciklit të dytë të studimeve; veç bursave të ekselencës, aplikohet edhe programi i bursave sociale. Studenti aplikon në Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, duke kërkuar bursë sipas rastit të tij/saj.</p> <p>Bazuar në RVB, 77% e studentëve të të dy viteve akademike të programit Master marrin bursë të pjesshme ose të plotë sipas kriterëve sociale.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 20.2: Programi i bursave; Shtojca nr. 20.3: Tabelë përmbledhëse me shpërndarjen e bursave MTR për vitet akademike 2021-2023].</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KU "LOGOS" ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Në faqen zyrtare të tij publikohen kuotat e studentëve për çdo program studimi të ciklit të dytë të ofruar, si dhe kriteret e përzgjedhjes.</i></p> <p><i>Si një institucion jofitimprurës, KU "LOGOS" pranon një numër të caktuar studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe burimet njerëzore, që zotëron, duke zbatuar edhe një politikë mbështetëse për personat me aftësi të veçanta, pakicat e shtresat e marginalizuara.</i></p>

	Në KU "LOGOS", bazuar në rregulloren përkatëse, publikohen dhe aplikohen çdo vit akademik edhe kriteret për pranimin e studentëve të huaj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Fletëpalosja informuese për studentët e vënë në dispozicion nga institucioni, ofron një informacion të plotë lidhur me procedurat e ecurisë akademike të studentëve. Po ashtu sekretaria mësimore, si njësi administrative institucionale, ka për detyrë dhënien e çdo informacioni të kërkuar nga studentët. Departamenti cakton një person përgjegjës, në rolin e këshilltarit akademik, për t'iu përgjigjur të gjitha nevojave për sqarime të studentëve e mbështetjes së tyre për probleme e vështirësi që mund të ndeshen gjatë procesit akademik.</p> <p>Kriteret për përparimin e studentëve përmenden gjithashtu në rregulloren e Fakultetit, rregulloren e Departamentit dhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.3: Rregullore e Programit të Studimit MSC TR; Shtojca nr. 13.1: Rregulloret për testimet e provimet, kriteret dhe procedurat e diplomimit; Shtojca nr. 13.2: Rregullorja e Diplomimit për MsC TR; Shtojca nr. 13.3: Rregullorja për tezën e Diplomës së Masterit; Shtojca nr. 2.3: Program Mësimor - Master TR; Shtojca nr. 9.3: Kalendari Akademik 2022-2023 Kolegji Universitar LOGOS].</i></p> <p>https://theolkulogosalb.wordpress.com/master-shkencor-në-turizem-religjioz-2/.</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Në rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar qartë kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Nenet e rregullores parashikojnë kushtet mbi plotësimin e njohurive formuese para hyrjes në program, mbi njohjen e krediteve për njohuritë e fituara më parë, etj.</p> <p>Një rregullore e posaçme e institucionit, lidhur me transferimin e studimeve, qartëson në mënyrë të hollësishme kriteret e këtij procesi, qoftë të transferimit të studentëve nga IAL të tjera apo brenda Kolegjit, mbi bazë kuotash të përcaktuara. Duke qenë se është program i ri, deri tani nuk ka asnjë rast të transferimit të studimeve gjatë kësaj periudhe.</p>




<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p><i>[Ref. Shtojca nr. 19.3: Rregullore e Transferimeve].</i></p> <p>Në një sërë dokumentesh të hartuara nga institucioni, si rregullorja themelore e tij, rregullorja e programit të studimit etj., janë përcaktuar qartësisht e në mënyrë të hollësishme kriteret e vlerësimit të dijeve të studentit, kriteret e kalimit në vitin pasardhës, e përmirësimit të mesatares së përgjithshme, kushtet e provimit e riprovimit, etj.</p> <p>Nga ana tjetër, sqarimi mbi kriteret e procedurat e vlerësimit u bëhet i njohur studentëve, që në javën e parë të prezantimit të lëndëve nga pedagogët përkatës. Silabuset e lëndëve, gjithashtu, përmbajnë kriteret e vlerësimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 25.1: Raporte të takimeve me studentët; Shtojca nr. 31.3: Komunikime në grup nëpërmjet Whatsapp].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit pasqyrohen kriteret dhe procedurat lidhur me punimin e diplomës. Nëpërmjet saj, studentët mund të marrin informacion mbi udhëheqësin e tezës, procedurën e vlerësimit të tezës, të drejtën e kushtet për ankimimin e tezës, por edhe rrjedhjet në rast plagjiature.</p> <p>I gjithë ky informacion përmendet në guidën studentore, si dhe në silabusin e tezës. Rregullorja e Praktikës i informon studentët për procesin e vlerësimit të tyre, qëllimet e praktikës, bashkëpunimin me mbikëqyrësin e tyre, sektorët ku mund të specializohen, dokumentacionin e nevojshëm për dosjen e praktikës dhe komisionin që do t'u nevojitet për të prezantuar përvojën e tyre të praktikës.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 2.4: Rregullore e Praktikës MSC TR; Shtojca nr. 13.6: Praktikë (dokumente të plotësuara) – shembull].</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Nga biseda në institucion dhe njohja e dokumentacionit, rezulton se KU "LOGOS" e ka si objektiv të përhershëm informimin dhe publikimin e të dhënave për programet e studimit për të gjithë të interesuarit e studentët. Nëpërmjet takimeve të hapura, panairëve të organizuara për këtë qëllim, broshurave e katalogëve të publikuar në faqet zyrtare, në mënyrë periodike bëhen të njohura programet e ofruara, përmbajtja e tyre, diplomat e fituara dhe rëndësia e aksesit në tregun e punës.</p> <p>Për realizimin e këtyre aktiviteteve njohëse, institucioni mbështetet edhe në bashkëpunimin me drejtoritë arsimore rajonale.</p> <p>IAL gjithashtu rreth 6 muaj përpara fillimit të çdo viti akademik, organizon fushata të gjera informuese me qëllim këshillimin për karrierë dhe rekrutimin e kandidatëve për studentë, ku marrin pjesë anëtarë të Zyrës së Çështjeve Studentore, anëtarë të personelit akademik, studentë të diplomuar (Alumni) dhe studentë për të zhvilluar takime informuese, Po ashtu Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës organizon aktivitete, që promovojnë turizmin religjioz (Java e Turizmit Religjioz) në kuadër të Forumit të Turizmit Religjioz (pjesë e programit Master), duke</p>





	<p>bashkëpunuar sipas marrëveshjeve institucionale me agjencitë dhe gjithashtu, nga ky vit akademik, ai do të ofrojë një shkollë verore për studentët e universitetit, të diplomuarit e Bachelor-it ose Master-it për studimet religjioze dhe turizmin religjioz.</p> <p>[Ref. Shtojca nr. 31.5: Njoftim për takim në lidhje me informimin për ciklin e dytë të studimeve - Njihu me KU "Logos"; Shtojca nr. 18.5: Kalendari i Këshillimit të Karrierës; Shtojca nr.30.5: Promovimi i programeve të Departamentit].</p>			
Konkluzione	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë bëhen publike nëpërmjet veprimtarive të hapura informuese, takimeve, panairove, broshurave e katalogëve të posaçëm, përmes faqeve zyrtare të internetit, por edhe nëpërmjet praktikës së bashkëpunimit me drejtoritë arsimore rajonale</p> <p>Nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, KU "LOGOS" vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit një informacion të plotë mbi të gjitha etapat dhe aspektet e procesit mësimor dhe përparimit akademik të tyre. Edhe njësitë administrative përkatëse janë gjithashtu në dispozicion të studentëve për çdo informacion.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Në aktivitetin "Njihu me Kolegjin Universitar Logos", që IAL organizon në fillim të çdo viti akademik, studentët njihen me personelin akademik dhe administrativ, me këshilltarët akademikë dhe marrin informacion të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <p>Personeli akademik, në detyrën e këshilltarit akademik, sipas udhëzuesit të posaçëm të miratuar nga institucioni dhe rregullores së organizimit akademik, ka të përcaktuara një sërë detyrash në ndihmë të studentëve për mbarëvajtje të suksesshme gjatë procesit mësimor. Po ashtu, organizatat studentore, si "Këshilli Studentor", shërbejnë për informimin e studentëve ose diskutimin e problemeve të tyre pranë organeve përkatëse.</p> <p>Informacionet mbi programet janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të institucionit, si dhe vihen gjithashtu në dispozicion nga këshilltari akademik, nëpërmjet adresës së mailit të studentëve:</p>

	<p>studenti@kulogos.edu.al, mediat sociale, platforma EduPage, Neo LMS dhe Ms Teams, rrjetet sociale, etj.</p> <p>Institucioni gjithashtu ka mjete të brendshme komunikimi, si njoftimet me postera brenda IAL-së, si dhe komunikimi verbal në auditor.</p> <p>Departamenti po ashtu organizon takimin e mirëseardhjes në fillim të vitit akademik.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.25.1: Raporte të takimeve me studentët; Shtojca nr. 20.4.1: Statuti i Këshillit Studentor; Shtojca nr. 20.4.2: Rregullore e Këshillit Studentor].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në mbështetje të studentëve, institucioni ka hartuar “Guidën e Studentit”, një udhëzues që u ofron atyre informacion të hollësishëm mbi procedurat e veprimtarisë mësimore. Gjithashtu, nëpërmjet sistemit Neo LMS, studentët informohen për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Rregullorja e programit të studimit përcakton parimet e funksionimit të programit, organizimin e studimeve, strukturën e planit mësimor sipas tipit të veprimtarive, me lëndët/modulet e kreditet përkatëse.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 18.6.1: Paketa informuese e studentit pjesa rregullative, statuti dhe rregullorja; Shtojca nr. 18.6.2: Zyrat me kontakte e-mail dhe personat përgjegjës].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në KU “Logos” janë ngritur struktura të posaçme në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës. Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës funksionon në ndihmë të studentëve për t’i ndihmuar ata në orientimin dhe këshillimin e karrierës. Ajo mundëson praktikatat profesionale të studentëve, sipas programeve e profileve të tyre, dhe ndjek nga afër procesin, i informon ata mbi teknikat e kërkimit të punës, shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake, si dhe organizon aktivitete, që synojnë ruajtjen e marrëdhënieve me studentët pas diplomimit.</p> <p>Departamenti ka themeluar gjithashtu për këtë qëllim edhe programin e mentorimit, “Ndërtoni karrierën tuaj” dhe ka publikuar udhëzuesin e karrierës për të ndihmuar studentët të ndërtojnë profilin e tyre profesional dhe të fillojnë të krijojnë mundësi për të punuar pas diplomimit të tyre.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB].</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni u vë studentëve në dispozicion informacion të detajuar e të përditësuar mbi zhvillimin e organizimin e studimeve. Në ditët e orientimit, “Njihu me Kolegjin Universitar Logos” dhe në “Guidën e Studentit” sqarohen çështje, që lidhen me organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën e shërbimet, që ofrohen në institucion, etj. Gjithashtu, në fillim të semestrit, pedagogu përkatës bën të njohur përmbajtjen e tematikën e lëndës, që do zhvillojë e që</p>





	<p>përmbahet në programin e studimeve, detyrimet e studentëve e kërkesat e tjera të lidhura me zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Studentët informohen gjithashtu për procesin mësimor nëpërmjet adresës së e-mail-it, si për orarin mësimor, orarin e provimeve, vendin e provimeve, konsultimet, etj.</p> <p>Po ashtu në faqen e internetit kanë të gjithë informacionin e nevojshëm.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 16.8: Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve].</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar një platformë të konsoliduar online, që i shërben procesit mësimor. Sipas GVB, studentët e KU "LOGOS" janë të informuar në kohë reale lidhur me programin e studimit përmes sistemeve EduPage, NeoLms dhe Ms Teams. Në institucion funksionon edhe zyra e IT, që është në dispozicion të studentëve për çdo nevojë e problematikë të aksesit të tyre në sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit.</p> <p>Komunikimi dhe informimi i studentëve kryhet edhe nëpërmjet sekretarive, pranë njësisë kryesore e asaj bazë.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 16.8: Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KU "LOGOS" vë në dispozicion të studentëve një informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formues, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit e mundësitë e punësimit.</i></p> <p><i>Në ditët e orientimit, në sistemet EduPage, NeoLms dhe Ms Teams dhe faqen zyrtare të institucionit, në "Guidën e Studentit", etj., ofrohet një informacion i zgjeruar mbi procedurat e veprimtarisë mësimore, logjistikën, infrastrukturën e shërbimet administrative.</i></p> <p><i>Në IAL janë ngritur struktura të posaçme, me detyra të përcaktuara institucionale, për të bërë ndërlidhjen e studentëve me tregun e punës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të</p>	<p>Nga vizita e biseda e GVJ në zyrën e sekretarisë mësimore, njohja me regjistrin bazë e mënyrën e plotësimit të tij, rezulton se procesi i regjistrimit të studentëve në programin e ciklit të dytë master, mbajtja e</p>





<p>diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>statistikave të tyre e të studentëve të diplomuar, kryhet në përputhje me procedurat përkatëse, sipas rregullores.</p> <p>Zyra krijon dosjen personale elektronike dhe të printuara për çdo student, mban statistika të rregullta dhe në mënyrë periodike, si dhe raporton mbi to në fund të çdo semestri. Zyra ka si detyrim jo vetëm përfshirjen e dokumentacionit të studentit në sistemin e menaxhimit të informacionit, por edhe përditësimin e këtij informacioni. Të gjitha procedurat që kryhen në zyrën e sekretarisë mësimore bazohen në rregulloren e saj, ku përshkruhen me hollësi rregullat dhe detyrat e organizimit dhe funksionimit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Shtojca: Tabela nr. 21: Cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga njohja e GVJ me dokumentacionin në zyrën e sekretarisë mësimore rezulton se ajo disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu, në procedurat që kryen, zyra ka edhe detyrimin për të dokumentuar rastet kur studenti mund të tërhiqet nga programi që ndjek, të largohet para përfundimit të tij, apo të mos e përfundojë me sukses vitin akademik. Këto të dhëna statistikore raportohen pranë njësisë përgjegjëse institucionale.</p> <p><i>[Ref. Shtojca: Tabela nr. 21: Cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje; Shtojca nr. 5.3: Raporti i departamentit 2021-2022].</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të gjitha të dhënat statistikore të studentëve që lidhen me procesin mësimor në KU "LOGOS", menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, i aksesueshëm nga personat përgjegjës të sekretarisë mësimore dhe këshilltari akademik, në kuadër të kompetencave që ai ka. Gjithashtu, Rregullorja e zyrës së sekretarisë mësimore parashikon, në përpunimin e të dhënave personale të studentëve, ruajtjen, administrimin dhe mbrojtjen e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 19.1: Regjistri i Regjistrimit të Studentëve; Shtojca nr. 19.2: Databazë e Studentëve; Shtojca nr. 5.3: Raporti i departamentit 2021-2022].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me</p>	<p>Bazuar në dokumentacioni përkatës, rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura praktike për monitorimin dhe mirëfunksionimin e njësive përbërëse administrative. Nëpërmjet auditimeve të brendshme, vlerësohet dokumentacioni dhe saktësia e informacionit, që lidhet me studentët. Këto auditime, të realizuara nga grupet e punës të ngritura për këtë qëllim, synojnë evidentimin e kontrollin e zbatimin të ligjshmërisë për çështjet sa më sipër, bazuar në rregulloret përkatëse të institucionit dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe i shërbejnë sigurimit të cilësisë në mënyrë të vazhdueshme në njësitë përbërëse të tij.</p>





studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<i>[Ref. Shtojca nr.11.2: Politika për sigurimin e cilësisë].</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës dhe nga biseda me drejtuesin e njësisë bazë përgjegjës për këtë program studimi, konstatohet se njësia harton raporte periodike analitike lidhur me ecurinë e procesit mësimor, cilësinë në hyrje e dalje të studentëve, shkallën e punësimit, si dhe me masat për përmirësimin e mëtejshëm të objektivave të saj. <i>[Ref. Shtojca nr.5.3: Raporti i departamentit 2021-2022].</i>			
Konkluzione	<p><i>Nëpërmjet zyrës së sekretarisë mësimore pranë institucionit, në përputhje me rregulloren, mblidhen, administrohen, ruhen dhe përditësohen të dhënat statistikore të studentëve. Zyra krijon dosjen personale dhe elektronike për çdo student, duke mbajtur statistika të rregullta dhe duke raportuar mbi to në mënyrë periodike.</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar politika dhe procedura praktike për monitorimin dhe mirëfunksionimin e njësive përbërëse administrative.</i></p> <p><i>Njësia kryesore dhe ajo bazë hartojnë raporte periodike analitike lidhur me ecurinë e procesit mësimor, cilësinë në hyrje e dalje të studentëve, shkallën e punësimit, si dhe me masat për përmirësimin e mëtejshëm të objektivave të programeve të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Bazuar në RVB, studentët kanë të drejtë të jenë të përfaqësuar në këshillat e tyre studentore, nëpërmjet të cilave ata mbështeten në të gjitha aspektet e jetës studentore e përfaqësohen pranë institucionit e autoriteteve të tjera në nivel kombëtar. Ata shprehin mendime e bëjnë propozime për çështje me interes të përgjithshëm të institucionit për planet dhe programet e studimeve, për hapjen e programeve të reja, për rregulloret e veprimtarisë mësimore, për cilësinë e shërbimeve, për tarifën e shkollimit, për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, oraret e provimeve, etj.</p> <p>Sipas ligjit të arsimit të lartë, studentët janë përfshirë gjithashtu në senatin akademik të institucionit, tek NJSBC, në komisionin e</p>





	<p>përhershëm të garantimit të cilësisë, Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët, Këshillin e Etikës dhe Këshillin Studentor. Përveç këtyre, Departamenti ka formuar një "institucion" të quajtur "Ambasadori i Studentëve" për përfshirjen e vazhdueshme të studentëve në aktivitetet, vendimmarrjen dhe politikat e Departamentit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 26.13: Vendim Departamenti i Teologjisë, Emërimi i Ambasadorit të Studentëve].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga biseda e GVJ në departament me studentët e programit të studimit, si dhe nga dokumentacioni përkatës, rezultojnë se studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit akademik në forma të ndryshme, si: nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillave të njësisë kryesore dhe bazë, në NJSBC, në grupet e punës gjatë procesit të akreditimit, në vlerësimin e veprimtarisë së institucionit dhe punës së stafit akademik.</p> <p>Po ashtu këshillat studentorë shprehin mendime dhe propozojnë zgjidhje për problemet me interes të përgjithshëm për institucionin. Kërkesat për realizimin e aktiviteteve të ndryshme apo kërkesat që vijnë prej tyre për përmirësimin e shërbimit, trajtohen në mënyrë të veçantë dhe me përparësi nga KU "LOGOS".</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 20.4.1: Statuti i Këshillit Studentor; Shtojca 20.4.2: Rregullore e Këshillit Studentor; Shtojca nr. 20.6: Rasti i miratimit të një kërkesë nga studentët MTR].</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nëpërmjet pjesëmarrjes në këshillat studentore, sipas statutit të KU "LOGOS", mundësohet përfshirja e studentëve, me mendime e propozime, në procesin e vlerësimit të planeve e programeve të studimit e hapjen e programeve të reja, në përmirësimin e rregulloreve e veprimtarisë mësimore. Nga ana tjetër, pjesëmarrja në mbledhjet e departamentit u krijon studentëve hapësirë për vlerësime dhe sugjerime të drejtpërdrejta lidhur me aspekte të ndryshme të procesit mësimor.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e institucionit çdo semestër i dërgon studentëve një pyetësor për të shprehur mendimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxëniet për çdo lëndë. Gjithashtu, Departamenti ka zhvilluar pyetësorë ekskluzivë për këtë program, duke kërkuar mendimin e studentëve për cilësinë e programit, cilësinë e shërbimeve studentore dhe për mundësitë akademike dhe të punës që ofron institucioni.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 29.1: Paketa e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë NJSBC; Shtojca nr. 26.11: Vendim Departamenti i Teologjisë Pyetësorët për Vetëvlerësimin e Departamentit].</i></p>





<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga biseda e GVJ me studentët e programit të studimit, rezulton se njësia bazë, në mënyrë koherente, u krijon atyre mundësinë për të dhënë mendime e propozime mbi korrektësinë e stafit akademik në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve dhe në përgjithësi, mbi integritetin e realizimit të procesit mësimor. Studentët vlerësuan se, si nga drejtuesit e departamentit, ashtu edhe nga ana e stafit akademik, ka gatishmëri e përgjegjësi për të reflektuar në raste ankimesh.</p> <p>[Ref. Shtojca nr. 26.6: Vendim Departamenti i Teologjisë Komisioni Mbikqyrës për Provimet].</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>KU "LOGOS", bazuar në akte ligjore e nënligjore e udhëzime të posaçme, përfshin dhe angazhon studentët në organe vendimmarrëse e këshilluese. Këshillat studentore shprehin mendime e bëjnë propozime për çështje me interes të përgjithshëm të institucionit mbi planet dhe programet e studimeve, hapjen e programeve të reja, rregulloret e veprimtarisë mësimore, cilësinë e shërbimeve, tarifave e shkollimit, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Në KU "LOGOS", bazuar në ligjin e arsimit të lartë, studentët janë përfshirë në senatin akademik të institucionit, tek NJSBC, në komisionin e përhershëm të garantimit të cilësisë, Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët, Këshillin e Etikës dhe Këshillin Studentor. Ata marrin pjesë në procesin e vlerësimit akademik në forma të ndryshme.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit të IAL-së publikohet i gjithë informacioni i nevojshëm mbi përmbajtjen e pranimit të studentëve. "Guida e studentit" është një udhëzues i plotë në shërbim të informimit të studentëve, ndërsa brenda institucionit funksionojnë për këtë qëllim njësitë e posaçme administrative, si zyra e sekretarisë mësimore dhe sekretaria e departamentit.</p> <p>KU "LOGOS" ka gjithashtu në strukturën e tij Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, si dhe këshilltarët akademikë pranë çdo departamenti për të ofruar orientim dhe këshillim në karrierë për studentët. Departamenti ofron po ashtu programin "Ndërtoni Karrierën Tuaj" me udhëzime të publikuara për karrierën e studentëve.</p>




	<p>[Ref. Shtojca nr. 26.1: Vendim i Përbashkët Departamenti i Teologjisë - Menaxhimit, Mentori Akademik; Shtojca nr. 26.2: Vendim Departamenti i Teologjisë Ndërto Karrierën].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të institucionit e RVB, në KU "LOGOS" funksionon një sistem eficient për informimin, këshillimin, ndjekjen e asistimin e studentëve përgjatë procesit mësimor. Takimet informuese, trajnimet apo udhëzuesit për stafin e studentët i shërbejnë drejtpërdrejt këtij qëllimi.</p> <p>Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës vazhdimisht organizon nëpërmjet një kalendari aktivitetesh të miratuara në fillim të çdo viti akademik, leksione të hapura, workshope, seminare informuese, që i orientojnë studentët se si të aplikojnë për vendin e punës, si të shkruajnë letrën e motivimit, CV-në etj.</p> <p>Studentët mund të hyjnë me kodet e tyre për të marrë informacion nga platforma EduPage në lidhje me përparimin e tyre akademik.</p> <p>[Ref. Shtojca nr. 31.4: Komunikim nga Mentori Akademik (Shembull – Tirana, kryeqyeti European i Rinisë)].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Para fillimit të çdo viti akademik, KU "LOGOS" organizon takime informuese me studentët, që përfundojnë nivelin Bachelor për t'i orientuar ata rreth mundësive të tyre për studime pasuniversitare në nivelin Master ose të diplomuarve të nivelit Master mbi mundësitë e tyre në tregun e punës, apo edhe në studimet e doktoratës.</p> <p>Këto takime zhvillohen me Dekanët, Drejtuesit e Departamenteve dhe përfaqësues të Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Studentët po ashtu informohen vazhdimisht nëpërmjet postës elektronike dhe kanaleve të tjera informative të KU "LOGOS".</p> <p>Bazuar dhe në RVB dhe intervistave në IAL, programi i mentorimit "Ndërtoni Karrierën Tuaj" i Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës i ofron asistencë profesionale studentëve për të ardhmen e tyre profesionale dhe akademike.</p> <p>Po ashtu, zyra e planifikimit të karrierës, në bashkëpunim me departamentin, mundëson dhe ndjek nga afër procesin e praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>[Ref. Shtojca nr. 25.1: Raporte të takimeve me studentët; Shtojca nr.31.5: Njoftim për takim në lidhje me informimin për ciklin e dytë të studimeve].</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës pranë KU "LOGOS", disponon të dhëna statistikore për punësimin e të diplomuarve, si Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës për të diplomuarit e vet në programin Bachelor në "Studime në Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze".</p>

<p>dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Kjo zyrë gjithashtu, si njësi institucionale administrative, harton raporte periodike mbi punësimin e studentëve, trajnimin e tyre, mundësitë e tregut etj., duke i vënë këto të dhëna në dispozicion qoftë të studentëve, ashtu edhe të organeve drejtuese të institucionit.</p> <p>Kështu bazuar dhe në RVB rezultojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> -95% e të diplomuarve janë të punësuar, ku 90% e tyre janë të punësuar në vende pune, që lidhen me studimet e tyre. -10% janë pjesë e personelit të KU "LOGOS". -55% janë duke studiuar në një program tjetër të KU "LOGOS" -30% janë duke studiuar në programin e ri Master i Shkencave në Turizëm Religjioz. <p>IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private për kryerjen e praktikave profesionale, të cilat në shumicën e rasteve rezultojnë se kanë ofruar punësim të mëtijshëm për studentët e diplomuar. KU "LOGOS" në bashkëpunim me Fakultetet, i ka ftuar studentët gjithashtu, që të bëhen pjesë e Panairëve të Punës, ku ka qenë i pranishëm, të cilët u japin studentëve mundësinë të njihen me punëdhënësit të mundshëm.</p> <p><i>[Ref. Minutat e Vizitës; Shtojca nr.5.3: Raporti i departamentit 2021-2022; Shtojca nr. 22.2: Marrëveshje me Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KU "Logos" ka hartuar politika dhe procedura, si dhe ka në dispozicion njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, për menaxhimin e ankimimeve e problematikave të tyre përgjatë zhvillimit të programeve të studimit..</i></p> <p><i>Njësi tjera institucionale, që funksionojnë në shërbim të studentëve janë Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, si dhe këshilltarët akademikë pranë çdo departamenti për të ofruar orientim dhe këshillim në karrierë për studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar procese të qarta vetëvlerësuese, për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë në bazë të fushës së studimit në turizmin religjioz. NJSBC ka si kompetencë hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe hartimin e standardeve për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë.</p> <p>IAL ka organizuar gjithashtu aktivitete dhe konferenca për trajnimin e lektorëve, në nivel universitar për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimore. Përveç këtyre, Departamenti ka botuar edhe libra të ndryshëm të fushës.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 16.3: Guidë për mësimdhënien inovative dhe metodat e mësimi; Shtojca nr. 21.3: Botime të Departamentit në funksion të programit; Shtojca nr. 21.4: Aktiviteti kërkimor-shkencor i stafit; Shtojca nr. 6.6: Mbështetje për Departamentin në kuadër të publikimit të teksteve].</i></p> <p>https://theolkulogosalb.wordpress.com/2023/02/09/teaching-innovation/ https://youtube.com/playlist?list=PLLISdlpsB3bHAFskoPW-q-WZn_aIA6qX</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Mekanismat përgjegjës janë zhvilluar nga struktura e NJSBC-së. Këto përfshijnë monitorimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Anketime me studentë për stafin akademik dhe lëndët e programit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”. Komponenti i tretë i këtij kriteri përbëhet nga formulari i vetëvlerësimit, që plotëson pedagogu, raportet semestrale dhe vjetore të marra nga njësitë bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Të gjitha këto të dhëna që NJSBC-ja vë në dispozicion, shërbejnë për të analizuar procesin akademik për programin e studimit të ofruar nga njësi bazë dhe në këto kushte rekomandon përmirësime për procesin.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit të lektorëve shqyrtohen edhe nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, i cili gjithashtu u jep rekomandimet e tij Departamenteve përkatëse. Po ashtu edhe Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës kryen vlerësime, përmes të cilëve vlerëson performancën e secilit lektor dhe metodologjinë e tij të mësimdhënies.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 26.11: Vendim Departamenti Pyetësorët për Vetëvlerësimin e Departamentit; Shtojca nr. 29.1: Paketa e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë NJSBC].</i></p>




<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik përmes anketimeve dhe vlerësimeve për personelin akademik dhe atë jo-akademik, të cilat sanksionohen në Statutin dhe Rregulloret e Institucionit. Vlerësimi bëhet për çdo lëndë dhe pedagog. Njësia bazë në vijim merr masa për përmirësimin e metodave të mësimdhënies që rezultojnë si pika kryesore nga studentët.</p> <p>NJSBC përgatit pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor, nivelin e shërbimeve arsimore, që ata marrin dhe përgjithësisht mendimin e tyre për Institucionin. Pyetësorët plotësohen në mënyrë anonime nga studentët për çdo semestër.</p> <p>Krahas pyetësorëve, Rregullorja e KU “Logos”, Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”, si dhe Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor sanksionojnë të drejtën e studentit për t’u ankuar për rezultatin përfundimtar të provimit dhe për të shprehur vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies së personelit akademik të Fakultetit nëpërmjet metodave të vlerësimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.</p> <p>Gjithashtu studentët kanë mundësinë e trajtimit të ankimimeve, bazuar në rregulloren e studimeve dhe provimeve në ciklin e dytë.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 29.1: Paketa e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë NJSBC; Shtojca nr. 3: Rregullore e Programit të Studimit MSC TR, neni 20].</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të gjitha rezultatet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, përfshirë raportet periodike, semestrale dhe vjetore, arkivohen dhe u bëhen me dije autoriteteve përkatëse të institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p> <p>NJSBC po ashtu përgatit raporte mbi vlerësimin e mësimdhënies së pedagogëve nga studentët dhe ua komunikon rezultatet e tyre individualisht pedagogëve. Raportet e vlerësimit të profesorëve dhe të departamenteve u vihen në dispozicion edhe Drejtuesve të Fakulteteve dhe të Departamenteve.</p> <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë gjithashtu analizon dhe i jep rekomandimet përkatëse Departamentit. Departamenti publikon çdo vit rezultatet e vlerësimit në raportin vjetor zyrtar të tij.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 5.3: Raporti i departamentit 2021-2022; Shtojca nr. 29.2: Procedura e administrimit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga NJSBC].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për</p>	<p>Pas marrjes së rezultateve të pyetësorëve, Departamenti organizon një mbledhje për të diskutuar rreth tyre, ndërsa Drejtuesi i Departamentit zhvillon diskutime personale me secilin lektor për rezultatet dhe performancën e tyre.</p>

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Sipas RVB-së, ezultatet e vlerësimit përdoren si burim për përmirësimin e cilësisë. <i>Megjithatë GVJ sugjeron që IAL, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, të promovojë shembuj të praktikave më të mira, duke nxitur personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</i> <i>[Ref. Shtojca nr. 25.2: Raporte të takimeve me stafin].</i>			
Konkluzione	Në përfundim, institucioni rezulton se ndjek një politikë të sigurimit të cilësisë në përputhje me këtë standard duke përmbushur kriteret si ndërtimi i proceseve të qarta vetëvlerësuese, për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë në bazë të fushës së studimit. Këto karakterizohen nga ekzistenca e mekanizmave monitorues, përfshirja e studentëve dhe transparenca. GVJ sugjeron që IAL, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, të promovojë shembuj të praktikave më të mira, duke nxitur personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përmbushje të këtij kriteri, institucioni ka themeluar NJSBC-në, e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Gjithashtu, Senati Akademik, në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015, ka krijuar Komisionin e Përhershëm për Vlerësimin Institucional, i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë të shprehura në Statutin e KU "LOGOS", përgjigjet për kryerjen e vlerësimit të brendshëm dhe shqyrton ankesat në kuadër të vlerësimit të brendshëm.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe	Institucioni ndjek procedurën e vlerësimit periodik çdo vit, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në fund të çdo semestri. Studentët marrin pjesë në vlerësimin e programit të studimit dhe të procesit mësimor. Programet e studimit dhe silabuset rishikohen në fillim të çdo viti akademik.




<p>bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>KU "LOGOS" ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të institucionit, si dhe Komisionin e Përherëshëm të Sigurimit të Cilësisë, në të cilin merr pjesë rregullisht një përfaqësues i trupit studentor.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 11.2: Politika për sigurimin e cilësisë, Shtojca nr. 12.2: Rregullore për sigurimin e cilësisë dhe instrumentet e miratuara; Shtojca: Tabela nr. 24 e tabelave mbështetëse].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Instrumentet e përdorura nga institucioni diskutohen dhe udhëzohen përpara se të miratohen nga Senati. NJSBC përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë e programit të studimit, si dhe metoda të vlerësimit të tërthortë dhe të drejtpërdrejtë sipas rregulloreve së saj dhe bashkëpunon me Departamentin e Teologjisë dhe Kulturës dhe Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjyhësor.</p> <p>Rezultatet e instrumenteve për sigurimin e cilësisë dhe Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë të shoqëruara me rekomandime, i përcillen nga Komisioni i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë Departamenteve për vlerësimin individual të profesorëve, si dhe për ndërtimin e konsultimeve. Sigurimi i jashtëm i cilësisë kryhet nëpërmjet ASCAL-it.</p> <p>Ky program studimi po i nënshtrohet akreditimit për herë të parë. Krahas këtyre, në vlerësimet periodike institucionale përfshihen edhe ekspertët e jashtëm të cilët japin mendimin e tyre rreth ecurisë që ka ndjekur institucioni për garantimin e cilësisë.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 29.2: Procedura e administrimit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga NJSBC; Shtojca nr. 26.10: Vendim Departamenti i Teologjisë Komisioni i Raportit për ASCAL (Msc TR)].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor instrumente të matjes së kërkimit shkencor, për të pasqyruar arritjet dhe dobësitë e stafit akademik.</p> <p>Institucioni ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Departamenti, në raportet periodike, i referohet ecurisë dhe qëllimeve, që duhen arritur sipas të dhënave që merr nga raportet periodike të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Institucionit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 5.3: Raporti i departamentit 2021-2022; Shtojca nr. 5.2 Plani Strategjik i Departamentit 2022-2025, kapitulli V].</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni e përmbush këtë standard plotësisht pasi vlerësohet se ka plotësuar kriteret 1-4, duke themeluar NJSBC-në, duke rregulluar përbërjen e saj, duke përfshirë edhe ekspertë të jashtëm, duke pasqyruar në mënyrë periodike vlerësimin akademik dhe shkencor të stafit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Departamenti është përfshirë në vlerësimin e programit të studimit. Vlerësimi bëhet në formë të dokumentuar në çdo mbledhje, që shqyrton mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në përfundim të vitit akademik, i gjithë stafi mbledhet dhe diskuton mbi veprimtarinë e departamentit, duke kontribuar edhe në përgatitjen e raportit vjetor.</p> <p>NJSBC-ja publikon gjithashtu çdo vit raporte mbi rezultatet e procesit të vlerësimit të programit të studimit.</p> <p>Bazuar dhe në RVB në procesverbalet e mbledhjeve të Dekanatit dhe të Asamblesë së Fakultetit paraqiten disa nga proceset dhe mekanizmat periodikë të shqyrtimit, miratimit dhe rishikimit të herëpashershëm të programit të studimit Master i Shkencave në “Turizëm Religjioz”.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 25.2: Raporte të takimeve me stafin; Shtojca nr. 29.3: Raport i NJSBC mbi vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies Semestri I-re 2021-2022].</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të NJSBC-së përfshijnë rezultatet, arritjet, identifikimin e mangësive dhe masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e rezultateve.</p> <p>Bazuar dhe në RVB, këto të dhëna përdoren nga raporti i vlerësimit të brendshëm të Departamentit dhe Fakultetit. Raporti vjetor i Departamentit përmban të dhëna për realizimin e qëllimeve dhe arritjet e programeve të studimit, projektet, kërkimin shkencor të lektorëve dhe studentëve, të dhëna nga programet e studimit, rregulloret, ngarkesën e punës, vlerësimet, përfaqësimin studentor në këshilla dhe të dhëna specifike për arritjet e studentëve dhe të të diplomuarve.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 5.3: Raporti i departamentit 2021-2022].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit,</p>	<p>Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, teste lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në teste ndërinstitucionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>




<p>vlërësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Gjithashtu, është miratuar formulari i vlerësimit të vazhdueshëm, i cili përfshin elementë si, silabusi, metodat e mësimdhënies, vlerësim të detyrave dhe projekteve, etj.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 29.4: Raporti vjetor i KPGSC 2021-2022].</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni përdor gjithashtu metoda të tërthorta për vlerësimin e programit të studimit, ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës, që përmban aspekte si përmbajtja e lëndës, mësimdhënia dhe të nxënit, mënyra e vlerësimit, njohja me silabusin, etj. <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve shërbejnë për progresin dhe rritjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Duke qenë se është program i ri dhe akreditimi i parë është e pamundur të mblidhen të dhëna nga intervistat me punëdhënësit dhe të diplomuarit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 25.1: Raporte të takimeve me studentët; Shtojca nr. 26.11: Vendim Departamenti Pyetësorët për Vetëvlerësimin e Departamentit].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Standardi përmbushet, pasi plotësohen kriteret e përcaktuara. Rezulton se institucioni nëpërmjet departamentit është përfshirë në vlerësimin e programit të studimit. Vlerësimi bëhet në formë të dokumentuar në çdo mbledhje, që shqyrton mbarëvajtjen e procesit mësimor. Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB institucioni ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në strukturat përgjegjëse për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të NJSBC-së, ka përfaqësues të studentëve dhe një ekspert të jashtëm.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 12.2: Rregullore për sigurimin e cilësisë; Shtojca nr. 11.2: Politika për sigurimin e cilësisë; Shtojca nr. 1.4: Rregullorja e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, nenet 31, 37].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>NJSBC funksionon sipas rregullores së saj dhe ka të qarta detyrat dhe përgjegjësitë për individët, studentët dhe palët e tjera. NJSBC vepron në mënyrë autonome dhe ushtron detyrat e saj me përgjegjësi.</p> <p>Departamenti gjithashtu ngre gjithashtu një komitet vlerësimi gjithëpërfshirës, i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.12.2: Rregullore për sigurimin e cilësisë; Shtojca nr. 11.2: Politika për sigurimin e cilësisë; Shtojca nr. 1.4: Rregullorja e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, nenet 31, 37].</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit (administrativ dhe akademik), njësia bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin e studimit, si dhe studentë të programit të studimit. Ata ofrojnë rekomandime dhe janë pjesë e procesit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.26.9: Vendim Departamenti i Teologjisë Komisioni për mbledhjen e të dhënave për RVB e Msc; Shtojca nr.26.10: Vendim Departamenti i Teologjisë Komisioni i Raportit për ASCAL Msc. TR].</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja e aktorëve të brendshëm bëhet gjithmonë duke respektuar integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie.</p> <p>Senati akademik ka për detyrë të garantojë respektimin e integritetit të të gjithë aktorëve të përfshirë në vlerësimin e cilësisë dhe të evitojë çdo lloj pabarazie apo diskriminimi ndaj të gjithë studentëve apo stafit akademik. Aktivizimi i personelit dhe studentëve respekton integritetin. Proceset ciklike të vlerësimit respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.25.1: Raporte të takimeve me studentët].</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të</p>	<p>Institucioni organizon takime të vazhdueshme me profesionistë të fushave të programeve, që ofron të cilët krahas ekspertizës</p>




<p>brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>informojnë edhe me dinamikat e tregut të punës me qëllim përcjelljen e tyre për ndryshime në programin përkatës.</p> <p>Po ashtu bashkëpunimi me agjenci turistike për programin e praktikës ka ndihmuar në shtimin e sesioneve dhe aktiviteteve të reja formuese, që ndihmojnë në zbatimin praktik të të dhënave teorike të lëndëve të kurrikulës.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.25.1: Raporte të takimeve me studentët; Shtojca nr.25.2: Raporte të takimeve me stafin; Shtojca nr.30.1: Aktivitetet në kuadër të programit MsC. në Turizëm Religjioz 2021-2023; Shtojca nr.5.3: Raporti i departamentit 2021-2022].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në departament për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të NJSBC-së, ka përfaqësues të studentëve dhe gjithashtu vërehet prania e ekspertit të jashtëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;">X</p>				

Standardi VI.5


Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në RVB, institucioni ka në fokus përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të IAL-së. Strategjia, politikat dhe procedurat e ndjekura nga institucioni për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë publikuar në broshura dhe në faqen e internetit të KU "LOGOS".</p> <p>http://www.kulogos.edu.al/al/index.html#</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr.31.1: Paraqitje e faqes së internetit KU LOGOS].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>http://www.kulogos.edu.al/al/science-turrel.html</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë</p>	<p>Të gjitha vlerësimet periodike shoqërohen me plan masash, ku u referohen pikave të forta të programit dhe të Departamentit. Ato përmbajnë</p>

përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>sugjerime për aspekte, që Departamenti mund të përmirësojë. Bazuar dhe në RVB ato janë marrë në konsideratë për përgatitjen e Planit të ri Strategjik të Departamentit, që është publikuar në shqip dhe në anglisht në faqen e internetit të Departamentit.</p> <p>https://theolkulogosalb.wordpress.com/, https://theolkulogos.wordpress.com/</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Siç rezultoi nga analiza e GVJ-së, raportimet e NJSBC-së përdoren në mënyrë efikase nga institucioni, duke i shpërndarë çështjet dhe ndjekur ato që kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>Fokusi kryesor është monitorimi i procesit mësimor, cilësia e programit të studimit, programi i praktikës dhe ndryshimi në jetën akademike të aktiviteteve jashtëkurrikulare.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 1.4: Rregullorja e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës].</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni organizon vazhdimisht takime informuese, trajnime me stafin dhe studentët. NJSBC-ja organizon seanca informuese me studentët dhe personelin e programeve të studimit me qëllimin ndërgjegjësimin e tyre për përfshirje aktive në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit.</p> <p><i>[Ref. Shtojca nr. 31.7: Opinionet e Studentëve mbi Draft-Raportin].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Veprimtaria e NJSBC-së është transparente dhe mund të aksesohet publikisht në faqen e dedikuar të saj ku ndodhen të gjitha raportimet e saj. Institucioni organizon në mënyrë periodike takime informuese me stafin dhe studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave i Nivelit të Dytë “Turizëm Religjioz” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Logos”

Pikat e forta dhe afirmime


1. Program unik studimi në IAL të Shqipërisë në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe promovimit të vendit.
2. Përfshirja e një personeli akademik ndërkombëtarë nga universitete të huaja.
3. Angazhimi i studentëve në nisma të pavarura (kurrikulare dhe jashtëkurrikulare).
4. Përgatitja e materialeve mësimore, botime nga Kolegji Universitar “LOGOS”.
5. Pjesëmarrja aktive e personelit akademik dhe e studentëve në kërkimin shkencor dhe publikimi i rezultateve në revista shkencore dhe konferenca ndërkombëtare.
6. Bashkëpunimi me institucione të jashtme publike dhe private, që garantojnë punësimin e të diplomuarve të programit.
7. Bashkëpunimi me industrinë turistike dhe komunitetet fetare për aktivitete dhe projekte, që garantojnë qëndrueshmërinë e programit të studimit.

Pika të dobëta

1. Numri i vogël i studentëve.
2. Numri i ulët i mobiliteteve.
3. Botimet e pakta mbi turizmin religjioz në gjuhën shqipe.
4. Mungesë e laboratorëve mësimor me programeve kompjuterike në funksion të përdorimit të teknologjisë në lëmin e turizmit me qëllim aftësimin praktik të studentëve para daljes në tregun e punës.

Rekomandime

1. Botime për turizmin religjioz në gjuhën shqipe.
2. Zhvillimi i një bashkëpunimi me institucione dhe komunitete fetare mbi projekte të përbashkëta, që do të kenë një qasje ndërdisiplinore mbi turizmin religjioz, historinë dhe kulturën e dialogut ndërkulturor dhe ndërfaqësor.
3. Realizimin e një studimi të mbështetur në intervista dhe anketimeve të grupeve të interesit në lëmin e turizmit në vend.
4. Literaturë e detyruar të jetë jo më shumë se dy burime dhe pjesa tjetër të përfshihet në literaturë të rekomanduar.
5. Staf i tërësishëm mbështetës më të madhe financiare nga ana e institucionit.
6. IAL të investojë në pajisjen e laboratorëve me programe kompjuterike në funksion të përdorimit të teknologjisë në lëmin e turizmit me qëllim aftësimin praktik të studentëve para daljes në tregun e punës.
7. Balancimi i mbulimit të ngarkesës mësimore me staf efektiv me kohë të plotë.
8. Hartimi i një liste të plotë, si dhe marrëveshjet specifike me secilin institucion.
9. Përgatitja e një raporti financiar në nivel të njësisë bazë dhe programit.



10. IAL, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, të promovojë shembuj të praktikave më të mira, duke nxitur personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences / Integrated Second Level Program "Religious Tourism" provided by the Higher Education Institution "Logos University College"

Strengths and affirmations

1. Unique study program in HEIs of Albania per the country's national development and promotion strategy.
2. Involvement of an international academic staff from foreign universities.
3. Engagement of students in independent initiatives (curricular and extracurricular).
4. Preparation of teaching materials, and publications by "LOGOS" University College.
5. Active participation of academic staff and students in scientific research and publication of results in scientific journals and international conferences.
6. Cooperation with external public and private institutions, which guarantees the employment of program graduates.
7. Cooperation with the tourism industry and religious communities for activities and projects that guarantee the sustainability of the study program.

Weaknesses

1. The small number of students.
2. Low number of mobilities.
3. Few publications on religious tourism in the Albanian language.
4. Lack of teaching laboratories with computer programs in function of the use of technology in the field of tourism for the purpose of practical training of students before entering the labor market.

Recommendations

1. Publications on religious tourism in the Albanian language.
2. Development of a collaboration with institutions and religious communities on joint projects, which will have an interdisciplinary approach to religious tourism, history and culture of intercultural and interreligious dialogue.
3. Realization of a study based on interviewees and surveys of interest groups in the field of tourism in the country.

4. Required literature to be no more than two sources and the rest to be included in the recommended literature.
5. The staff should have greater financial support from the institution.
6. HEI to invest in the equipment of laboratories with computer programs in the function of the use of technology in the field of tourism with the aim of practical training of students before entering the labor market.
7. Balancing teaching load coverage with effective full-time staff.
8. Drawing up a complete list, as well as specific agreements with each institution.
9. Preparation of a financial report at the level of the basic unit and the program.
10. HEI, through evaluation mechanisms and results obtained, promotes examples of best practices, encouraging academic staff to further improve teaching.

